



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 113**

**30 gusht**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM

nr. 480, datë 25.7.2012

Për miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave “Për reagimin  
ndaj ndotjeve detare në Republikën e Shqipërisë” .....

6523

**VENDIM**  
**Nr. 480, datë 25.7.2012**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË EMERGJENCAVE**  
**“PËR REAGIMIN NDAJ NDOTJEVE DETARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 32, 398 dhe 401 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr. 8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9692, datë 8.3.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi (OPRC) 1990””, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e planit kombëtar të emergjencave “Për reagimin ndaj ndotjeve detare në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe institucionet e tjera shtetërore, si dhe organet që kanë interesat e tyre në det për kontrollin dhe zbatimin e këtij plani kombëtar.

3. Ngarkohet QNOD-ja të bashkërendojë punën me institucionet e përmendura në pikën 2 për plotësimin e anekseve të nevojshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**PLANI KOMBËTAR I EMERGJENCAVE**  
**PËR REAGIMIN NDAJ NDOTJEVE DETARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**  
**KORRIK 2012**

**1. PREZANTIMI**

**Historiku i përgjithshëm**

1.1 Republika e Shqipërisë (këtej e tutje do t’i referohemi si “Shqipëria”) është anëtare e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit 1982, dhe kështu që ka detyrimin të mbrojtje dhe të ruajtje mjedisin detar. Plani kombëtar i emergjencës për reagimin ndaj ndotjes detare aksidentale (këtej e tutje do t’i referohemi si “plani”) është një nga masat që do të ndërmarrë Shqipëria për përputhjen me këtë detyrim.

1.2 Pas ruajtjes dhe shpëtimit të jetës së njerëzve, qëllimi kryesor i reagimit ndaj një aksidenti është të mbrojtë shëndetin njerëzor, mjedisin detar dhe atë bregdetar. Agjenci të ndryshme kombëtare, rajonale dhe lokale do të reagojnë ndaj incidenteve që shkaktojnë ose rrezikojnë të shkaktojnë ndotje të detit dhe të bregdetit shqiptar.

1.3 Plani plotëson dokumentacionin që ka të bëjnë me përgjegjësinë e qeverisë shqiptare për shpëtimin e jetës në det dhe për kërkim shpëtimin.



1.4 Plani është i harmonizuar me traktatet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit detar në të cilat Shqipëria është palë. Lista me këto traktate ndërkombëtare është dhënë në aneksin 1.

#### Baza ligjore

1.5 Plani bazohet në legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë mbi përgjegjësitë dhe detyrimet e institucioneve të përmendura në plan, prej të cilave mund të përmendim:

- Ligji nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8875, datë 4.4.2002 “Për rojën bregdetare shqiptare”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 954, datë 30.9.2009 “Për organizimin, strukturën, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 439, datë 13.5.2011 “Për miratimin e politikave dhe procedurat e funksionimit të QNOD”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8905, datë 6.6.2002, mbi “Për mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Mbrojtja dhe Dëmtimi”; i ndryshuar.
- Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Mbi emergjencat civile”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligji nr. 7746, datë 29.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar.
- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe në porte”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1214, datë 3.9.2008 “Për miratimin e strategjisë së sektorit të transportit”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 24.9.2010 “Për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit”.
- Plani kombëtar për emergjencat civile, i miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 3 dhjetor 2004.

Një listë më e plotë e akteve normative ligjore kombëtare gjendet në aneksin 2.

1.6 Plani prek detyrimet që Republika e Shqipërisë ka nën Konventën Ndërkombëtare për Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes Detare nga Nafta, 1990 (OPRC 90) dhe sipas Konventës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Zonës Bregdetare të detit Mesdhe, 1995 (Konventa e Barcelonës) dhe protokollet e saj në lidhje me bashkëpunimin në parandalimin e ndotjes nga anijet, dhe në rastet e emergjencës, lufta kundër ndotjes për detin Mesdhe, 2002, dhe sipas çdo marrëveshje ndërkombëtare mbi bashkëpunimin dhe asistencën e reciproke, në të cilën Shqipëria është ose mund të bëhet palë. Një listë me këto marrëveshje dhe traktate mbi bashkëpunimin dhe asistencën reciproke në rastet e incidenteve të ndotjeve detare në të cilën Shqipëria është palë është e pasqyruar në aneksin 1.

#### Qëllimi dhe objektivat

1.7 Qëllimi i këtij plani është të garantojë ekzistencën e një reagimi të përkohshëm, uniform dhe efektiv në nivel kombëtar ndaj incidenteve të ndodhura në det, që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit detar nga nafta ose substanca të tjera të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat e tejkalojnë kapacitetin e reagimit individual të anijeve, porteve, terminaleve të naftës, kantierëve detare, platformave detare, dhe të autoriteteve lokale ose rajonale.

1.8 Objektivi kryesor i planit është të organizojë një reagim të shpejte dhe efektiv ndaj derdhjeve të naftës dhe substancave të tjera të rrezikshme dhe helmuese që ndikojnë ose kanë tendenca të prekin zonën detare të Republikës së Shqipërisë dhe bregdetin e saj, si dhe të lehtësojë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në detet Adriatik, Jon dhe Mesdhe.

#### 1.9 Objektivat specifike të planit janë:

- Të përcaktojë përgjegjësitë dhe politikat për reagimin ndaj aksidenteve me ndotje detare;
- Të krijojë një organizim operativ të zbatueshëm, me përfaqësues nga të gjitha autoritetet dhe institucionet e përfshira, dhe të vendosë zonat e tyre të përgjegjësisë;
- Të vendosë parimet e drejtimit dhe koordinimit dhe të përcaktojë strukturat përkatëse të reagimit;
- Të identifikojë zonat me rrezikshmëri të lartë;
- Të identifikojë zonat me prioritet për mbrojtje dhe pastrim;
- Të përcaktojë një politike dhe strategji kombëtare për reagimin ndaj rrjedhjeve të naftës ose të substancave të rrezikshme dhe helmuese;
- Të sigurojë që për një nivel minimal, vendosjen paraprake të llojeve të përshtatshme të veglave/pajisjeve që do të përdoren gjatë reagimit ndaj ndotjes detare me qëllimin që të garantojë zbatimin përkatës të politikës dhe strategjisë kombëtare ndaj rrjedhjeve;
- Të mundësojë udhëheqje dhe të sigurojë kompensimin e dëmtimit nga ndotja;
- Të përcaktojë politika kombëtare për trajnimin e personelit që merr pjesë në reagimin ndaj ndotjes detare;
- Të sigurojë një nivel të përshtatshëm të parapërgatitjes në nivel kombëtar, duke kryer ushtrime për reagimin ndaj ndotjes;
- Të lehtësojë zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë të cilat Shqipëria është vend anëtar.

1.10 Plani përshkruan sistemin kombëtar të parapërgatitjes dhe reagimit, duke përfshirë si burimet private ashtu edhe ato publike, për reagimin ndaj emergjencave që rezultojnë ose mund të rezultojnë nga derdhjet e naftës apo të substancave të tjera të dëmshme dhe të rrezikshme në mjedisin detar.

#### Reagimi i përshkallëzuar

1.11 Plani është i bazuar në konceptin e pranuar botërisht të “reagimit të përshkallëzuar”, i cili mundëson një trajtim strukturor për ndërtimin e parapërgatitjeve për t’u përballur ndotjen nga derdhjet e naftës dhe lëndëve të rrezikshme dhe helmuese, dhe për të ndërmarrë masa kundër ndotjes në rastet e incidenteve në mënyrë të tillë që burimet shtesë mund të përdoren dhe integrohen brenda një operacioni reagimi nëse rrezikshmëria e incidentit rritet. Koncepti përfshin tri “shkallë” reagimi. Incidentet janë kategorizuar në çdo shkallë në varësi të sasisë së ndotësit të derdhur, si dhe vendit të incidentit, megjithatë kufizimet e shkallëve nuk janë përcaktuar. Plani përcakton shkallën 1 të reagimit si shkalla bazë në porte, pajisjet që lidhen me naftën, instalimet bregdetare dhe platformat detare, të cilat kombinojnë me njëri-tjetrin dhe mund të kombinohen me ato pajisje në pronësi të autoriteteve dhe shërbimeve kombëtare për të krijuar mundësi bashkëpunimi për të përballuar operacionet më të vështira të reagimit që mund të kategorizohen në shkallës 2 dhe ato akoma më të vështira të kategorizuara në shkallën 3.

1.12 Përcaktimi i shkallëve të ndryshme mund të varet nga kushtet e çdo porti apo pajisjeje, dhe do të varen nga analiza e rrezikut që do të ndërmerret si pjesë e aktivitetit parapërgatitor për reagimin ndaj derdhjes së naftës.

1.13 Shkalla 1 mbulon përgatitjen dhe reagimin ndaj një ndotjeje të vogël brenda apo në afërsi të një porti apo pajisje individuale dhe që mund të përballohet me burimet e tyre.

1.14 Shkalla 2 mbulon përgatitjen dhe reagimin ndaj një ndotjeje që i tejkalon mundësitë reaguese të një porti apo pajisje individuale, ose ndodhet jashtë zonës së reagimit të shkallës 1.

1.15 Shkalla 3 mbulon derdhjet madhore që kërkojnë mobilizimin e të gjitha burimeve kombëtare në gjendje, si edhe mobilizimin e burimeve dhe ekspertizës së jashtme.

1.16 Për qëllim të reagimit emergjent, në çdo njërën nga shkallët e mësipërme ekziston një autoritet i përcaktuar (shiko seksionin 2), i cili ushtron drejtimin nëpërmjet një qendre operimi (shkalla 1 – operatorët dhe menaxherët e një instalimi detar, porteve ose autoriteteve portuale,



Drejtoria e Përgjithshme Detare, shkalla 2 – prefekti i qarkut në bashkëpunim me agjencitë rajonale të mjedisit në bashkëpunim me Forcën Detare Shqiptare, shkalla 3 – QNOD) me mbështetjen e një skuadre për menaxhimin e incidentit.

1.17 Plani aktual kryesisht i referohet reagimit në shkallën 3.

Zonat e mbulimit

1.18 Plani do të zbatohet në rastet e incidenteve që shkaktojnë ose kanë tendencë të shkaktojnë ndotje në mjedisin detar, mbi shtratin e detit dhe në tabanin detar të Republikës së Shqipërisë, të cilat përfshijnë; brigjet, lagunat bregdetare, zotërimet detare, detin territorial dhe [me vendosjen e zonës së mbrojtur të peshkimit dhe zonës së mbrojtur ekologjike]. Harta e zonave gjeografike të mbulimit të planit është e pasqyruar në aneksin 3.

1.19 Plani mbulon vetëm reagimin ndaj ndotjes nga karburanti dhe lëndët e rrezikshme dhe helmuese, të cilat mund të shkaktohen nga një incident në det. P.sh., incident me anije ose një incident që përfshin një platformë detare.

1.20 Ujërat sipërfaqësorë të brendshëm si lumenjtë dhe liqenet nuk mbulohen nga ky plan dhe gjithashtu plani, gjithashtu, do të zbatohet në rast ndotje detare me origjinë nga toka që mund të depërtojë në det apo në lumenj.

Përkufizime

1.21 Për qëllime të planit, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin si vijon:

“Anije” do të thotë një mjet i çdo tipi që operon në ambientin e marinës dhe përfshin varkat hidrofoil, mjetet me jastëk ajri, varka zhytëse dhe lundruese të çdo tipi.

“Autoritetet kombëtare” do të thotë ministrinë, departamentet dhe agjencitë e Republikës së Shqipërisë.

“Autoriteti qeveritar përgjegjës” do të thotë departamenti kompetent i qeveritar i ngritur që ka përgjegjësi administrative dhe politike për trajtimin e aksidenteve dhe/ose ndotjes operative detare (p.sh.: QNOD-ja, Forca Detare Shqiptare).

“Autoriteti operativ përgjegjës” do të thotë autoriteti kompetent i ngritur për të ushtruar përgjegjësinë operative në trajtimin e ndotjes aksidentale detare.

“Autoritetet rajonale përgjegjëse” do të thotë agjencitë rajonale mjedisore (ARM) dhe Forca Detare Shqiptare për qëllim të planeve rajonale të emergjencës

“Autoritetet lokale” do të thotë “Institucioni i prefektit të qarkut dhe njësitë e qeverisjes vendore (Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, emergjencat civile, Policia e Shtetit dhe Shërbimi Publik).

“Derdhje madhore” do të thotë një derdhje e karburantit në sasi të një shkalle të lartë për të cilën koha dhe vendi është i pamundur të parashikohet, dhe e cila mund të shkaktojë pasoja të rënda mjedisore.

“Derdhje e karburantit” në det do të thotë derdhja, shkarkimi ose rrjedhja aktuale ose e mundshme e karburantit në ujërat e detit territorial të Shqipërisë.

“Dispersant (shpërndarës kimik ose shpërndarës për karburantin)” do të thotë përzierje e lëngshme e agjenteve që veprojnë në sipërfaqe të një ose më shumë tretësve organik, të formuluar në mënyrë specifike për të rritur shpërndarjen natyrore të karburantit në kolonën e ujit të detit duke reduktuar tensionin ndërmjet karburantit dhe ujit.

“Incident” do të thotë një përplasje anijesh, ngecja në cekëtime, zjarri, shpërthimi, dëmtim strukturor, incident gjatë lundrimit, ose ndodhi të tjera në bordin e anijes ose jashtë saj me rezultat dëmtimin e materialeve ose kërcënim i materialeve të dëmtuara të anijes ose të ngarkesës, gjithashtu, një ngjarje në njësi detare.

“Incident i ndotjes së detit” do të thotë çdo ngjarje ose varg ngjarjesh me origjinë të njëjtë, e cila rezulton ose mund të rezultojë me shkarkim të karburantit ose lëndëve të tjera të dëmshme e të rrezikshme dhe, e cila paraqet ose mund të paraqesë një kërcënim ndaj mjedisit detar ose të vijës

bregdetare ose të interesave të ngjashme të një ose më shumë shteteve, të cilat kërkojnë veprime emergjente ose reagim të menjëhershëm.

“Incident me ndotje nga nafta” do të thotë çdo ngjarje ose varg ngjarjesh me origjinë të njëjtë, e cila rezulton ose mund të rezultojë me shkarkim të karburantit, e cila paraqet ose mund të paraqesë një kërcënim ndaj mjedisit detar ose të vijës bregdetare ose të interesave të ngjashme të Shqipërisë apo të një ose më shumë shteteve fqinje, dhe të cilat kërkojnë veprime emergjente ose reagim të menjëhershëm.

“Industri naftë” do të thotë zbuluesit dhe prodhuesit, rafinuesit dhe tregtaret e karburanteve, si edhe transportuesit e lidhur dhe kontraktuesit e shërbimit

“Karburant” do të thotë nafta e çdo forme, duke përfshirë naftë bruto, lëndë djegëse naftë, llum, mbeturina naftë dhe produkte të rafinuara.

“Kërcënim” do të thotë ndikimi i mundshëm ose pasojat që mund të shkaktojë një derdhje karburanti ose lende tjetër e rrezikshme, e dëmshme ose helmuese nëse hyn në kontakt me një burim biologjik, social ose ekonomik.

“Kontrolluesi i incidenteve” është një term i përgjithshëm që i referohet personit përgjegjës për funksionimin e portit, vendqëndrimit, mjeteve ndihmëse, instalimit ose planit të emergjencës ndaj ndotjes detare në bordin e anijes.

“Substancat e rrezikshme dhe helmuese” do të thotë çdo substancë, përveç karburantit, e cila nëse futet në mjedisin detar mund të krijojë rrezik ndaj shëndetit njerëzor, të cenojë gjallesat dhe jetën detare, të dëmtojë pajisjet ose të ndërhyjë në përdorimet e tjera të ligjshme të detit, dhe ngjitur me zonën bregdetare (përfshirë dhe derivatet e karburantit, substancat e lëngshme, të cilat janë të dëmshme ose të rrezikshme, gazet e lëngshme, lëngje me pikën maksimale të ndezjes jo më shumë se 600, materiale të paketuara të rrezikshme e të dëmshme, dhe materiale të ngurta të lidhura me kimikate të rrezikshme.

“Mbeturina naftë” do të thotë mbeturina që përmbajnë naftë.

“Ndotës” do të thotë të gjitha lëndët ndotëse duke përfshirë si karburantet ashtu edhe substancat e rrezikshme dhe helmuese.

“Njësi detare” do të thotë çdo instalim në det i fiksuar artificialisht apo lundruar, ose strukturë e përdorur, ose me qëllimin për t’u përdorur, në ose mbi, ose e ankoruar ose e ngjitur me shtratin e detit me qëllim për të eksploruar ose shfrytëzuar, në lidhje me përpunimin, ngarkimin ose shkarkimin e çdo minerali duke përfshirë edhe karburantin.

“Parandalimi (i ndotjes nga karburanti ose lëndë e rrezikshme dhe helmuese në det)” do të thotë çdo veprim i kryer gjatë operimit normal të anijes, platformës detare, linje tubacioni, ose mjeti për transportin e karburantit ose lëndë e rrezikshme dhe helmuese për të ulur mundësinë e ndodhjes së një rrjedhje karburanti ose lëndë të rrezikshme dhe helmuese.

“Plani” do të thotë plani kombëtar i emergjencës për reagimin ndaj ndotjes aksidentale detare në Republikën e Shqipërisë.

“Plan emergjence” do të thotë një plan i parapërgatitur në pritje për zbatim gjatë reagimit ndaj një incidenti me ndotje detare.

“Reagimi ndaj derdhjes së naftës” do të thotë veprimet e kryera për të konfirmuar prezencën e një derdhje naftë, për të ndaluar rrjedhën nga burimi, përmbajtjen, mbledhjen, mbrojtjen e zonave nga dëmtimi, zvogëlimin e efektit mjedisor dhe pastrimin e kafshëve të egra dhe zonave të kontaminuar nga derdhja.

“Rehabilitimi biologjik” do të thotë një varg procesesh të ndërmarra për të shpejtuar degradimin biologjik natyral të ndotësve (naftës apo substancave të rrezikshme dhe helmuese). Këtu përfshihen në veçanti përdorimi i ushqyesve (biostimulator) dhe mbledhja e mikrobeve të zgjedhura veçanërisht për të pakësuar naftën (shtimin natyral ose mbjelljen).



“Vendstrehim” do të thotë një vend në të cilin një anije mund të ankorohet ose akostohet për të bërë të mundur marrjen e masave për të minimizuar efektet e dëmtimit (p.sh. minimizuar derdhjen e naftës).

“Zonat bregdetare” do të thotë i gjithë bregdeti shqiptar brenda valës së zbatimit në zonën e bregut, plazhet dhe ligatinat.

## 2. SISTEMI SHQIPTAR I REAGIMIT NDAJ NDOTJES DETARE – PËRGJEGJËSIA DHE ORGANIZIMI

### Përgjegjësia

2.1 Në lidhje me planin, autoritetet përgjegjëse për aktivitetet në lidhje me parapërgatitjen dhe reagimin ndaj ndotjeve aksidentale detare nga karburantet ose lëndët e rrezikshme dhe helmuese janë përcaktuar si më poshtë:

Shkalla	Zona e përgjegjësisë	Institucioni / organizata
Shkalla 3	Kombëtare	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)
Shkalla 2	Rajonale	- Prefekti i Qarkut, Agjencitë Rajonale Mjedisore (ARM), përgjegjësini kryesore për operacionet në breg dhe në tokë; - Forca Detare përgjegjëse për operacionet e reagimit ndaj ndotjes në det
Shkalla 1	Lokale	- Operatorët dhe menaxherët e porteve/autoriteteve portuale dhe instalimeve në breg apo në det, bashkitë apo komunat përkatëse; - Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare monitorimin

Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) më detyrë mbrojtjen e mjedisit në zonën që është ndotur nga incidenti, si edhe Drejtoria e Përgjithshme Detare, e cila ka përgjegjësinë për portet, radat dhe anijet që kryejnë veprime në këto porte, janë përgjegjëse në shkallën 1 për monitorimin e të gjitha operacioneve pa pasur parasysh autoritetin/institucionin përgjegjës për të kryer operacionet e pastrimit.

2.2 Rolet dhe përgjegjësitë e QNOD-së dhe të çdo administrate, organizate, shërbimi dhe institucioni të parashikuar për të marrë pjesë në reagimin ndaj ndotjes aksidentale detare, në përputhje me planin aktual janë të përshkruara në shtojcën 4.

2.3 Detajet e kontakteve të administratave, organizatave, shërbimeve dhe institucioneve të listuara në shtojcën 4, dhe të personave përgjegjës brenda tyre janë dhënë në shtojcën 5.

### Shkalla 3

2.4 Komponentët kombëtar të reagimit në shkallën 3 janë QNOD-ja, prefekti i qarkut, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Forca Detare Shqiptare, Drejtoria e Përgjithshme Detare kontraktuesit private dhe publike, konsulentët, gjithashtu, dhe ministrinë, agjencitë dhe shërbimet përkatëse. Në veçanti përveç institucioneve pjesëmarrëse në QNOD, qendra do të bashkëpunojë me Agjencinë përkatëse që mbulon sektorin e naftës në ministrinë përgjegjëse për energjinë (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, AKBN) në lidhje me aktivitetet e ndërmarrja nga agjencitë shtetërore dhe subjekteve përgjegjëse për sektorin e karburantit në zonat detare që janë subjekte të këtij plani.

2.5 QNOD-ja ka një përgjegjësinë kryesore për përgatitjen dhe zbatimin e planit, dhe për të përforcuar, zbatuar dhe mbikëqyrur në emër të Republikës së Shqipërisë, të gjitha aktivitetet në lidhje me përgatitjen për reagimin ndaj ndotjes detare të shkaktuar nga karburanti ose substancave të rrezikshme dhe helmuese në rast emergjence (shiko, gjithashtu, edhe paragrafët 5.7 dhe 5.8, si edhe seksionin 16).

2.6 QNOD-ja brenda kompetencave të saj, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare duhet të ushtrojë përgjegjësi të njëjta mbi portet, limanet, terminalët e karburantit, mjetet e tjera bregdetare dhe njësi detare, në lidhje me përpunimin e planeve të emergjencës, zbatimin e tyre në raste emergjence, si dhe aktivitetet e tjera në lidhje me parapërgatitjen dhe reagimin.

2.7 Detyrimin për organizimin dhe drejtimin e operacioneve reaguese në shkallën 3 e ka QNOD-ja. Kur, për shkak të përmasave, ndërlikimit dhe ndikimit mjedisor, reagimi ndaj incidentit me ndotje detare i tejkalon mundësitë dhe rezervat në dispozicion të shkalla 1 dhe shkalla 2, QNOD-ja pranon përgjegjësinë për menaxhimin e reagimit sipas këtij plani. Nëse emergjenca i tejkalon kapacitetet reaguese që përballohen nga QNOD-ja, atëherë krijohet Komiteti Ndërmnistror për Menaxhimin e Emergjencës sipas pikës 5.14 të këtij plani.

2.8 Për zbatimin e planit, QNOD-ja mbështetet nga administrata kombëtare, organizata, shërbime dhe institucione të tjera përkatëse.

2.9 Nëse ndodh një derdhje masive karburanti, në çdo pjesë të detit nën juridiksionin shqiptar dhe reagimi ndaj saj i kalon kapacitetet në dispozicion brenda vendit, QNOD-ja do të kërkojë asistencë ndërkombëtare për reagimin në shkallën 3. Në rastet kur operacioni i reagimit përfshin asistencën ndërkombëtare, do të kryhet në zbatim të dispozitave të planit në fjalë, nën koordinimin dhe drejtimin e përgjithshëm të Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar dhe koordinatorit në terren.

2.10 Çdo vit QNOD-ja nëpërmjet drejtorit administrativ i raporton Këshillit të Ministrave mbi gjendjen e përgatitjes për reagimin ndaj një ndotje detare.

#### Shkalla 2

2.11 Detyrimin kryesor për përgatitjen dhe reagimin e operacioneve të shkallës 2 e kanë prefekti i qarkut dhe Forca Detare në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale Mjedisore (ARM).

2.12 Prefekti i qarkut në bashkëpunim me Forcën Detare dhe QNOD-në kanë përgjegjësinë për të përgatitur, mbajtur dhe zbatuar planin rajonal të emergjencës për zonën përkatëse të përgjegjësisë.

2.13 Prefekti i qarkut është përgjegjës drejtpërdrejtë për planëzimin, organizimin dhe kryerjen e aktiviteteve reaguese në breg në përputhje me planin rajonal të emergjencës, si edhe ligjin nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar dhe aktet ligjore nën zbatim të tij.

2.14 Nën drejtimin e QNOD-së, Forca Detare organizon dhe kryen operacionet reaguese ndaj ndotjes në det, në përputhje me planin rajonal të emergjencës.

2.15 Zona e përgjegjësisë së Forcës Detare mbulon zonën ndërmjet kufirit detar shqiptaromalazez deri në kufirin detar shqiptarogrek.

2.16 Forca Detare do të reagojë ndaj incidenteve me ndotje detare në det që e kalon kapacitetin reagues të shkallës 1 të portit/mjetit brenda zonës së mbulimit. Forca Detare do të reagojë edhe ndaj ndotjeve në det kur pala përgjegjëse nuk mund të identifikohet. Forca Detare është përgjegjëse për mbajtjen e sasive të mjaftueshme të pajisjeve përkatëse reaguese ndaj ndotjes dhe QNOD-ja do të garantojë që Forca Detare të jetë e pajisur me trajnime dhe mundësi për të ushtruar ekspertizën e tyre me qëllim ndërmarrjen në mënyrë sa më kompetente të rolit që u përcaktohet.

2.17 Në rastet e operacioneve reaguese në det të shkallës 2, Koordinator i Përgjithshëm nëpërmjet QNOD-së kërkon bashkëpunimin me Forcën Detare dhe komandanti i anijes së Forcës Detare, e cila do të jetë e para në vendin e ngjarjes do të marrë rolin e koordinatorit në terren dhe do të drejtojë operacionet reaguese në det deri në mbërritjen e një oficeri epror. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit në terren janë përshkruar në paragrafët 2.33-2.38.

2.18 Pa marrë parasysh madhësinë e incidentit, prefekti i qarkut, agjencitë rajonale të mjedisit, drejtuesit e Forcës Detare, si edhe kapiteneritë përkatëse në mënyrë të menjëhershme do të lajmërojnë QNOD-në për çdo incident me ndotje detare të ndodhur brenda zonës së tyre të mbulimit.

2.19 Plani i emergjencës në shkallën 2 do të aktivizohet nga prefekti i qarkut që ka përgjegjësinë për zonën bregdetare në të cilën ka ndodhur incidenti, ose oficeri drejtues i Forcës Detare që ka përgjegjësinë për zonën detare, nën mbikëqyrjen e Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar. Para aktivizimit të planit, prefekti i qarkut ose Komandanti i Forcës Detare verifikon informacionin mbi incidentin dhe ndotjen dhe menjëherë vlerëson situatën.





2.20 Personeli dhe rezervat e Forcës Detare për reagimin në shkallën 2 do të luajnë, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në operacionet reaguese në det të shkallës 3. Në rastin kur incidenti me ndotjeje kalon në shkallën 3 të reagimit, reaguesit e shkallës 2, do të vazhdojnë operacionet edhe gjatë periudhës së ndërrimit të niveleve me qëllim që të formojnë një pjesë integrale dhe vitale të aktivitetit të pastrimit në shkallën 3.

2.21 Nëse, oficeri drejtues i Forcës Detare që ka marrë rolin e koordinatorit në terren është i mendimit që reagimi ndaj ndotjes i kalon kapacitetet dhe burimet në dispozicion, ai duhet të informojë pa vonesë QNOD-në dhe t'i kërkojë Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar ta përshkallëzoje reagimin në shkallën 3.

#### Shkalla 1

2.22 Operuesit dhe menaxherët e të gjitha instalimeve në breg, duke përfshirë portet, kantieret detare, vendet e transferimit të karburanteve, platformat detare (duke përfshirë pajisjet dhe platformat), linjat e tubave dhe anijet nga të cilat mund të ndodhë ndonjë derdhje karburanti ose substance të rrezikshme dhe helmuese në mjedisin detar, janë përgjegjës (vetë ose qiramarrësit) për përgatitjen e planeve lokale të emergjencës dhe për mirëmbajtjen e kapaciteteve reaguese të mjaftueshme për reagimin fillestar ndaj incidentit me ndotje që mund të ndodhë në pajisjet e tyre. Në veçanti, përgjegjësia për përgatitjen dhe aktivitetet reaguese në mjediset e portit e ka drejtuesi i portit apo autoritetit portual përkatës. Një listë e plotë e këtyre instalimeve ndodhet në aneksin 6.

2.23 QNOD-ja në konsultim me ARM-në dhe Forcën Detare përkatëse, duhet të përcaktojë zonën e saktë të përgjegjësisë të çdo mjeti apo platforme detare të përmendur në paragrafin 2.22.

2.24 Operatori/menaxheri i çdo porti apo autoriteti portual, pajisjeje në breg apo instalimi në det do të emërojë nga stafi i tij, një person përgjegjës për aktivitetet në lidhje me përgatitjen dhe reagimin, dhe në veçanti për zbatimin e planit lokal të emergjencës të shkallës 1. Ky person emërohet si “kontrolluesi i incidentit”.

2.25 Kontrolluesi i incidenteve lajmëron pa vonesë kapitenerinë e portit përkatës dhe QNOD-në për çdo derdhje të konstatuar, dhe ndërmerr hapa të menjëhershme për të vënë nën kontroll atë, si dhe të ndjekë udhëzimet e planin lokal të emergjencës përkatës. Nëse kontrolluesi i incidentit kërkon mbështetje ose nëse ARM-ja dhe oficeri përkatës i rojës bregdetare e vlerësojnë se reagimi i nevojshëm i kalon mundësitë aktuale, oficeri përkatës i Forcës Detare për operacionet në det dhe prefekti i qarkut për operacionet në tokë, do të vendosen në drejtimin dhe kontrollin e operacioneve reaguese në det dhe/ose në breg duke e shkallëzuar në shkallën 2. Në të njëjtën mënyrë Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar mund ta shkallëzojë një incident të shkallës 1 në incident të shkallës 3.

2.26 ARM-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare janë përgjegjëse për monitorimin e operacioneve reaguese të kryer gjatë operacioneve të shkallës 1 të përshkruar në paragrafin 2.22 dhe listuar në aneksin 6.

2.27 Plani i emergjencës në shkallën 1 aktivizohet nga kontrolluesi i incidentit i portit, autoritetit portual, pajisjeve detare dhe në breg në ato zona përgjegjësie ku ka ndodhur incidenti me ndotje.

2.28 Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe kapiteneritë përkatëse të portit duhet të sigurojnë që të gjitha anijet që futen në detin territorial të Republikës së Shqipërisë, ujërat e brendshëm, porte, terminale, instalimet detare, siç kërkohet nga rregulloret e Organizatës Ndërkombëtare Detare, të kenë një plan emergjence ndaj ndotjes detare në bord (SOPEP).

2.29 Në rast të një rrjedhjeje të mundshme nga ndonjë anije, kapiteni i anijes është përgjegjës për lajmërimin e autoriteteve bregdetare, si dhe të sigurojë fillimin menjëherë të përpjekjeve për të vënë nën kontroll rrjedhjen. Në varësi të rrethanave dhe burimeve/mjeteve në dispozicion, kapiteni mund të urdhërojë fillimin e operacionit reagues.

#### Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar

2.30 QNOD-ja e ushtron kontrollin e saj në incidentet e shkallës 3 nëpërmjet Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar. Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar do të jetë përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për mjedisin pranë QNOD-së. Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar është përgjegjës për drejtimin e përgjithshëm në të gjitha rastet e incidenteve potenciale me ndotje detare që kanë origjinë nga anijet apo instalimet në det që kërkojnë një reagim kombëtar. Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar është personi i vetëm përgjegjës për marrjen e vendimeve për aktivizimin e reagimit kombëtar duke përfshirë aktivizimin e këtij plani.

2.31 Kur përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për mjedisin në QNOD, për ndonjë arsye nuk mund të marrë rolin e Koordinatorit të Përgjithshëm, ky rol i kalohet njërit prej përfaqësuesve të tjerë të ministrisë përgjegjëse për mjedisin në QNOD ose ndonjë personi tjetër i caktuar nga ministri përgjegjës për mjedisin.

#### Koordinatori në terren

2.32 Koordinatori në terren caktohet nga Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar për çdo incident specifik me ndotje deri në mbërritjen në vendin e ngjarjes së anijes së Forcës Detare. Koordinatori në terren do të jetë komandanti i anijes së Forcës Detare që mbërrin e para në vendin e ngjarjes deri në mbërritjen e një oficeri epror. Koordinatori në terren duhet të ketë njohuri të mira dhe eksperiencë në operacionet e reagimit ndaj ndotjes detare.

2.33 Në rastet e reagimit në shkallën 3, koordinatori në terren merr kontrollin dhe do të jetë në krye të menaxhimit të operacioneve të reagimit ndaj ndotjes të ndodhur në det apo në ajër. Në rastet kur është e përfshirë ndonjë anije ai mbikëqyr operacionin e transferimit të ngarkesave, si dhe organizon shpërndarjen e mjeteve/pajisjeve të nevojshme. Është përgjegjësia e koordinatorit në terren për t'i sugjeruar Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar shkallëzimin e reagimit nga shkalla 2 te shkalla 3, kur sipas mendimit të tij, përmasat, komplikimi ose ndikimi i pritur për mjedisin gjatë një incidenti me ndotje detare e kërkon, ose kur kërkohet nga autoritetet rajonale përgjegjëse.

2.34 Për çdo derdhje karburanti koordinatori në terren duhet të përpiqet të:

- Minimizojë, dhe kur është e mundur, të ndalojë ndotjen e mëtejshme nga derdhja e karburantit ose e substancave të rrezikshme dhe helmuese në det;
- Të marrë gjitha masat e nevojshme për shpërndarjen, ndalimin dhe mbledhjen, ose pastrimin e karburantit ose substancave të rrezikshme dhe helmuese në përputhje me planin.

2.35 Koordinatori në terren është koordinatori kryesor i mjeteve që marrin pjesë në operacionit kundër ndotjes. Kur është e mundur, ai do të ndjekë rrjedhën e përgjithshme të veprimeve si më poshtë:

- të ndërmarrë hapat e nevojshëm, përfshi dhe marrjen e mostrave, për identifikimin e burimit të derdhjes;
- të parandalojë çdo derdhje që mund të ndodhë;
- ndalojë rrjedhjen e mëtejshme;
- minimizojë, dhe kur është e mundur, ndalojë përhapjen e ndotësit;
- zvogëlojë çdo efekt të dëmshëm nga derdhja;
- mbrojtë burimet, zonat dhe speciet e rrezikuara;
- monitorojë efektet e rrjedhjes;
- marrë parasysh këshillat e ekspertëve të përshtatshëm dhe të kualifikuar;
- pajisjet dhe heqë ndotjen;
- sistemojë mbetjet e mbledhura në mënyrë të përshtatshme.

2.36 Koordinatori në terren është përgjegjës për garantimin e shëndetit dhe sigurisë së publikut, aktivistëve dhe çdo personeli që merr pjesë në reagimin ndaj derdhjes.



2.37 Në rastet e operacioneve ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është përcaktuar si shtet udhëheqës, koordinatori në terren pranon automatikisht rolin e komandantin suprem në terren dhe do të koordinojë operacionin ndërkombëtar të reagimit me shtetet e përfshira. Megjithatë këtë rol mund ta vendosë dhe ta pranojë personalisht edhe Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar.

2.38 Koordinatori në terren punon në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e institucioneve të tjera të interesuara në zonën e ndotur nga incidenti.

Aktivizimi i planit kombëtar të emergjencave

2.39 Plani aktivizohet nga Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar në rastet e incidenteve brenda zonës detare shqiptare, i cili ndot apo kërcënon me ndotje detin territorial, bregdetin apo zona të tjera me interes për Republikën e Shqipërisë apo të një apo më shumë shteteve fqinje, ashpërsimi i së cilës i kalon kapacitetet reaguese të shkallës 1 dhe shkallës 2. Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar është përgjegjësi i vetëm për aktivizimin e planit dhe operacioneve reaguese të shkallës 3.

2.40 Në rastin kur Koordinatori i Përgjithshëm merr vendimin për të aktivizuar planin, lajmëron menjëherë mbi aktivizimin të gjitha institucionet, administratat, shërbimet dhe organizatat përkatëse lokale apo rajonale që kanë interesat e tyre në det.

Zonat me përparësi për zbatimin e planit kombëtar të emergjencës

2.41 Përparësi në termat e zbatimit të planit do të jepen për të ruajtur zonat e ndjeshme detare, zonat kulturore detare, zonat e shumimit të peshkut, dhe zonat arkeologjike nënujore të përmendura në shtojcën 7.

2.42 Lista e zonave të ndjeshme detare dhe ato arkeologjike nënujore mbahet te QNOD-ja dhe rifreskohet çdo vit.

### 3. RAPORTIMI DHE NJOFTIMI I DERDHJES

Lajmërimi fillestar

3.1 Çdo person që shkakton ose konstaton ndotje të detit ose një aksident që mund të rezultojë me ndotje detare, duhet të lajmërojë menjëherë të paktën një nga institucionet, si: Kapitenerinë e Portit m përgjegjëse të afërt, QNOD-në, policinë, Drejtorinë e Përgjithshme Detare, Drejtorinë Operacionale të Drejtim-Komandimit të Emergjencave Civile, zjarrfikëset ose çdo institucion tjetër kombëtar.

3.2 Kapitenet e anijeve ose personat e tjerë që kanë në ngarkim anijen ose instalimin (njësinë) detar janë të detyruar të raportojnë pa vonesë, me radio, telefon apo me çfarëdo mjeti tjetër, çdo ndodhi në anije ose në platformë që ka të bëjë me rrjedhjen ose mundësinë e rrjedhjes së karburantit ose lëndëve të rrezikshme dhe helmuese, duke përfshirë humbje të paketave që përmbajnë lëndë të rrezikshme dhe helmuese, te Kapiteneria e Portit, QNOD-ja ose stacionin e radios bregdetare. Ata janë të detyruar të japin të paktën informacionin e përmendur në paragrafin 3.8. Nëse një incident ndodh brenda portit, terminalit të naftës, kantierit detar apo në një njësi detare, personi në ngarkim duhet të raportojë atë menjëherë te Kapiteneria e Portit.

3.3 Detyrimin për të raportuar derdhjen apo mundësinë e derdhjes të karburantit ose lëndë të rrezikshme dhe helmuese e kanë të gjitha anijet, jo vetëm ato që u kërkohet të kenë në bordin e anijes një plan emergjence për reagimin ndaj një ndotje detare.

3.4 Çdo organizatë ligjore apo person fizik që merr njoftimin për ndotje detare të çdo lloji apo sasive, ose një kërcënim për ndotje detare, nga një anije, platforme detare ose burim të panjohur, duhet t'ia përcjellë këtë informacion menjëherë QNOD-në.

3.5 Çdo institucion që merr njoftim për një incident me ndotje, duhet të përcjellë pa vonesë këtë informacion te QNOD-ja. Më pas, QNOD-ja do ta shpërndajë informacionin mbi ndotjen institucioneve që kanë interesat e tyre në det duke përfshirë edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile.

3.6 Shtetasit, kapitenët e anijeve, operatorët e njësive detare ose personat e të njëjtit nivel që nuk njoftojnë autoritetin përkatës më të afërt për ndotjen detare do të ndëshkohen dhe moskryerja e saj do të konsiderohet si kundërvajtje administrative.

3.7 QNOD-ja dhe Kapiteneritë e Porteve, do të mundësojnë numra telefoni kontakti 24-orë për raportimin e incidenteve të ndotjes së detit nga karburanti. Drejtoria e Përgjithshme Detare do të mbajë listën e institucioneve të tjera, të cilëve mund t'u dërgohet njoftimi, si dhe numrat e tyre të kontaktit.

3.8 Oficeri i shërbimit të QNOD-ja ose oficeri i ndonjë organi tjetër kombëtar që merr një njoftim nga personat e përmendur në pikat 3.1-3.4 të planit do të përpiqet të marrë, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

- emrin, numrin e telefonit dhe detajet e tjera ligjore apo natyrale të personit që raporton ndotjen tek autoritetet kompetente;

- data dhe ora e konstatimit të ndotjes ose aksidentit që mund të shkaktojë ndotje detare;

- vendndodhjen e ndotjes detare ose aksidentit që mund të shkaktojë ndotje detare;

- përshkrimin, intensitetin dhe arsyen e ndotjes detare karakteristikat dhe sasinë e ndotësit;

- informacion mbi burimin ose burimin e mundshëm të ndotjes detare (anije, njësi detare, burimet e ndotjes nga toka);

- motin dhe gjendjen e detit në zonë.

3.9 Gjithë informacioni i mbledhur nga institucionet në lidhje me paragrafin 3.8 do t'i përcillet pa vonesë QNOD-së në përputhje me procedurat standarde të funksionimit të Qendrës.

3.10 Tabela e vazhdimësisë së lajmërimit dhe procedura në rastin e një derdhje të karburantit ose lendeve të rrezikshme dhe helmuese është e përshkruar në aneksin 8 të planit.

Verifikimi dhe plotësimi i informacionit

3.11 Me marrjen e informacionit për ndotjen detare ose të një incidenti që mund të shkaktojë një ndotje detare, oficeri i QNOD-së, në detyrë, ka detyrimin të kontaktojë pa vonesë anijen ose njësinë detare, për të verifikuar informacionin fillestar dhe të kërkojë të paktën informacionin shtesë të mëposhtëm nga personi përgjegjës i anijes ose njësisë detare:

- tipi (natyra) e incidentit (përplasje, dalje në cekëtime, shpërthim, humbje e kontejnerëve etj.);

- numri i personave në bordin e anijes ose njësisë detare;

- tipi, përmasat dhe emri i anijes ose njësisë detare;

- identiteti i pronarit/ operatorit të anijes ose njësisë detare;

- agjenti i anijes në Republikën e Shqipërisë;

- vendndodhja e saktë, drejtimi dhe shpejtësia e anijes dhe afërsia e saj me anijet e tjera, instalimet detare, ujerat e cekëta dhe bregu;

- shkalla e rrezikut për jetën e njerëzve, informacion mbi personat e plagosur dhe mundësia e dhënies ndihme për personat e plagosur;

- informacioni mbi mallin e anijes, depot dhe cisternat dhe nëse paraqesin rrezikshmëri;

- integriteti strukturor dhe mekanik i anijes ose i njësisë detare;

- shtrirja e dëmtimit në anije ose në njësinë detare;

- moti, gjendja e detit dhe kushtet e baticës;

- çdo asistencë e mundshme ndaj ngjarjes dhe qëllimet e kapitenit ose personit përgjegjës të anijes ose njësisë detare;

- veprimet e ndërmarra për eliminimin e kërcënimeve dhe pasojave potenciale.

3.12 Me qëllimin për të grumbulluar sa më shumë informacion që të jetë e mundur, formatet dhe procedurat standarde të njoftimit ndërkombëtar ekzistues në rastet e derdhjes së karburanteve (POLREP) do të përcillet në çdo kohë që të jetë e mundur. Sistemi i raportimit të ndotjes POLREP është përcaktuar në shtojcën 09.



3.13 Në varësi të rrethanave oficeri i QNOD-së ose i Qendrës së Kërkim-Shpëtimit në detyrë do të fillojë pa vonesë çdo operacion kërkim-shpëtimi të nevojshëm.

3.14 Oficeri në detyrë i QNOD-së që merr informacionin duhet të përcjellë, pa vonesë, Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar, një raport, i cili të përmbledhë të gjitha të dhënat e grumbulluara dhe procedurat rreth ndotjes detare ose të incidenti që mund të shkaktojë atë.

3.15 Në aneksin 10 është riprodhuar një formular lajmërimi i brendshëm, i bazuar mbi standardet dhe rregulloret ndërkombëtare. QNOD-ja do të pajisë ministritë, departamentet dhe agjencitë përkatëse të përfshira në reagim me formularin përkatës për njoftim.

#### 4. VLERËSIMI I DERDHJES DHE VENDOSJA E NIVELIT TË REAGIMIT

4.1 Është përgjegjësia e kontrolluesit të incidentit (në shkallën 1), prefektit të qarkut për ndotjen në breg dhe në tokë dhe oficerit drejtues të Forcës Detare për ndotjen në det (në shkallën 2) dhe koordinatorit në terren (te shkalla 3) për të vlerësuar situatën në mënyrë të shpejtë në bazë të informacionit të marrë në kohën e njoftimit fillestar të rrjedhjes dhe të lajmërojë menjëherë Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar mbi rezultatet e këtij vlerësimi.

4.2 Për të vlerësuar situatën përdoren faktorët e mëposhtëm:

- vendndodhja e incidentit;
- tipi(at) e ndotësit(sve);
- sasia e ndotësit që është /ose mund të shkaktohet
- të dhënat meteorologjike (shpejtësia dhe drejtimi i erës, gjendja e detit dhe kushtet e baticës, temperatura e detit) dhe të dhënat mbi rrymat e detit (shpejtësia dhe drejtimi);
- mundësia e lëvizjes së ndotësit;
- niveli i rrezikut ndaj jetës së njerëzve dhe /ose rreziku potencial ndaj shëndetit njerëzor;
- kapacitetet në përdorim për reagimin ndaj ndotjes
- rreziku nga zjarri/shpërthimi;
- shtrirja e mundshme e dëmtimit të burimeve natyrore;
- shtrirja e mundshme e dëmtimit të aktiviteteve ekonomike.

4.3 Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar vendos menjëherë çfarë shkalle reagimi (kombëtar, rajonal ose lokal), kërkon incidenti. Plani nuk vendos kritere të ngurta për vendosjen e një shkalle reagimi kombëtare apo rajonale. Gjithsesi Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar mund të vendosë një reagim kombëtar nëse:

- kur ka një aksident midis anijeve që rrit rrezikun për ndotje dhe që kërkon një operacion shpëtimi;
- kur ka një derdhje karburanti ose çdo lëndë tjetër të dëmshme dhe të rrezikshme në det nga një anije, dhe kërkohet shpërndarja e mjeteve/pajisjeve detare ose ajrore që të përmbajnë, shpërndajnë ose neutralizojnë atë;
- kur ka një derdhje të karburantit ose substancave të rrezikshme dhe helmuese nga një njësi detare, e cila kërkon shpërndarjen, nga Drejtoria e Përgjithshme Detare të pajisjeve detare ose ajrore që përmbajnë, shpërndajnë ose neutralizojnë atë, ose veprim tjetër përtej mundësisë së autoritetit portual (pas lejimit për mbështetje reciproke të rënë dakord me operatorët e tjerë);
- kur ka një rrjedhje të karburantit ose lëndëve të rrezikshme dhe helmuese brënda zonës së autoritetit portual/portit, e cila kërkon shpërndarjen e mjeteve/pajisjeve kombëtare nën kontrollin e autoriteteve kombëtare për mbajtjen, shpërndarjen ose neutralizimin e tyre, ose veprime të tjera përtej kapacitetit të autoritetit portual/portit (pas lejimit të mbështetjes reciproke të ndërmarra me autoritetet portuale fqinje); ose
- një autoritet lokal apo rajonal kërkon shpërndarjen e mjeteve/pajisjeve për pastrimin e vijës bregdetare nën juridiksionin kombëtar, pasi reagimi i kalon kapacitetet e autoritetit lokal/rajonal pas lejimit të ndonjë mbështetjeje reciproke të ndërmarrë me autoritetet fqinje.

4.4 Një anije e përfshirë në një incident që shkakton ose mund të shkaktojë ndotje, ka nevojë për asistencë ose mund të bëhet një rrezik potencial nëse ekspozohet më tej në faktorët e detit të hapur, QNOD-ja duke u konsultuar me autoritetet e tjera përkatëse kombëtare mund të vendosë të japë lejen për strehimin e kësaj anije. Si pjesë e aktivitetit parapërgatitor, QNOD-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare do të përpiqet të identifikojë vendstrehime të mundshme të bazuar në një analizë objektive të avantazheve dhe dis-avantazheve për lejimin e një anije në nevojë të akomodohet në këtë vendstrehim (seksioni 11).

4.5 Gjatë operacioneve rajonale të reagimit (shkalla 2), Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar për të mbështetur autoritetet rajonale ose autoritetet lokale, mund të shpërndajë mjete dhe pajisje që kontrollohen nga QNOD-ja. Në reagimin lokal (shkalla 1), QNOD-ja nuk ka ndonjë rol tjetër përveçse të mbaje rekorde të ndotjes për qëllime statistikore.

4.6 Në rastet e ndonjë derdhjeje madhore, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar duhet të kërkojë pa vonesë mbikëqyrje ajrore (nga ndonjë helikopter ose aeroplan me krahë, nëse është e mundur me një vëzhgues të kualifikuar) për monitorimin e vazhdueshëm të përhapjes së ndotjes dhe lëvizjen mbi sipërfaqen e detit.

4.7 Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar do të marrë në konsideratë veprimet e mëposhtme, disa prej të cilave kanë të bëjnë me shpërndarjen e pajisjeve që kontrollohen nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, ndërsa të tjerat që kërkojnë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve kombëtare që nuk kontrollohen nga Drejtoria e Përgjithshme Detare:

- të angazhojë për inspektimin e anijes një vëzhgues të Kapitenerisë së Portit, mbikëqyrës teknik nga Drejtoria e Përgjithshme Detare ose çdo person tjetër të kualifikuar;
- të mbajë në gatishmëri ose shpërndajë:
- anije ose avionë që lëshojnë dispersantë
- mjete për mbledhjen e karburantit,
- shirita kufizues,
- mjete/pajisje për transferimin e mallit
- varka për tërheqjeje emergjente;
- të përcaktojë mundësinë për shpëtimin dhe lehtësimin e anije-s/ve;
- të transportojnë anijen në ndonjë vendstrehim;
- të informohet për kushtet specifike të motit;
- të kërkojë kontrollin e hapësirës ajrore në afërsi të vendngjarjes; dhe
- vendosjen e një zone të përkohshme ndalimi.

Veprimet që merren pas fillimit të një operacioni reagimi rajonal apo kombëtar

4.8 Kur një kërcënim për një ndotje të konsiderueshme justifikon si reagimin rajonal apo atë kombëtar, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar informon menjëherë, dhe kur është e nevojshme thërret skuadrën e menaxhimit të incidentit. Pjesëtarët e skuadrës së menaxhimit të incidentit dhe rolet e tyre përkatëse dhe/ose përgjegjësitë janë dhënë në shtojcën 11.

4.9 Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar garanton që QNOD-ja të mbajë rekorde për të gjitha veprimet e kryera gjatë operacioneve të reagimit ndaj incidentit me ndotje detare. Gjithashtu, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar merr masa që të gjitha raportet t'u dërgohen ministrive përkatëse dhe/ose agjencive kombëtarë dhe ndërkombëtare.

Kriteret për përshkallëzimin e masave reaguese

4.10 Personi përgjegjës për zbatimin e planit të emergjencës (kontrolluesi i incidentit në shkallën 1 ose prefekti i qarkut dhe oficeri drejtues i Forca Detare përkatëse në shkallën 2) lajmëron Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar nëpërmjet koordinatori në terren nëse reagimi ndaj ndotjes i kalon apo mund t'i kalojë kapacitetet reaguese që janë në dispozicion të tyre.

4.11 Përkatësisht kontrolluesi i incidentit dhe drejtuesi i ARM-së dhe drejtuesi i Forcës Detare, do të përdorin kriteret e përshtatshme të mëposhtme, për përcaktimin e reagimit sipas shkallës 1 dhe /ose shkallës 2 ndaj ndonjë incidenti me ndotje detare specifike:



- përmasat e rrjedhjes – nëse volumi i karburantit ose substancave të rrezikshme dhe helmuese së derdhur (ose që mund të derdhet) mund t'i tejkalojë kapacitetet, mjetet, ose ekspertizën në dispozicion të agjencisë që kryen reagimin.

- karakteri i lëndës së derdhur – nëse lloji i karburantit ose substancës së rrezikshme dhe helmuese mund të jetë një nga ato për të cilat nevojiten ekspertiza dhe mjetet e specialisteve të reagimit;

- vendndodhja e derdhjes – nëse vendndodhja e derdhjes mund të jetë e vështirë për t'u arritur, mund të kërkojnë mjete të specializuara, ose mund të jetë në breg;

- natyra ose shtrirja e ndikimit të karburantit ose substancës së rrezikshme dhe helmuese – nëse ndonjë kombinim i llojit dhe karakterit të karburantit ose substancës së rrezikshme dhe helmuese, lokalizimit të derdhjes, kushteve mjedisore, llojit të vijës bregdetare, dhe afërsia me zonat e ndjeshme që mund të ndikojë në përmasat e ndonjë impakti të krijuar;

- mundësi për ndonjë rrjedhje të mëtejshme – nëse natyra e incidentit (dalje në cekëtinë, përplasje, shkarkim aksidental etj.) mund të luajë një rol në përcaktimin e mundësisë të ndonjë derdhjeje tjetër ose derdhje të mëtejshme sipas madhësisë së anijes; dhe

- kostoja e reagimit – nëse reagimi ndaj derdhjes së karburantit ose substancës së rrezikshme dhe helmuese përfshin shpenzimin e një sasive të madhe parash, të cilat në varësi të ndotjes mund të kërkojnë kohë për t'i rimarrë.

4.12 Ndërsa reagimi ndaj derdhjes përshkallëzohet në nivelin tjetër, përgjegjësia për kontrollin qëndron tek autoriteti më i lartë, deri në përfundimin e reagimit. Kjo bëhet për të garantuar përputhje dhe uljen e mundësisë së keqinterpretimit të vendimeve të reagimit. Kjo do të sigurojë, gjithashtu, llogaritjen e shpenzimeve përkatëse.

4.13 Rezervat e përfshira në një reagim mund të rriten ose të pakësohen në kohë të ndryshme sipas kërkesave operacionale. Përgjegjësia për të kompletuar reagimin e ka autoriteti më i lartë.

Përfundimi i operacioneve të reagimit

4.14 Kriteri për të përfunduar operacionin e reagimit do të përcaktohet nga Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar në bashkëpunim me skuadrën e menaxhimit të operacionit. Për përfundimin e operacionit do të merret parasysh një game e gjerë parametrash unike the natyrës individuale të çdo incidenti. Përfundimisht, vendimin final për përfundimin e reagimit e ka Koordinatori i Kombëtar në Terren me pëlqimin e Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar. Gjithashtu, ai do të kërkojë ndërprerjen e financimeve për shpenzimet e mëtejshme të pastrimit.

## 5. MENAXHIMI I REAGIMIT NDAJ INCIDENTEVE ME NDOTJE DETARE

5.1 Emergjencat, si derdhja e karburantit ose lëndëve të rrezikshme dhe helmuese në det, kërkojnë veprime të shpejta, vendimtare dhe të mirinformuara. Një sistem kontrolli dhe drejtimi i pastër dhe efektiv, është parësor siç janë dhe njohuritë dhe ekspertizat e kërkuara për zbatimin e sistemit. Këto përdoren veçanërisht gjatë operacioneve të reagimit në shkallën 3. Struktura kombëtare për menaxhimin e operacioneve të reagimit ndaj një incidenti madhor me ndotje detare (shkalla 3) në Shqipëri është përshkruar si më poshtë:

5.2 Reagimi ndaj një incidenti madhor me ndotje nga karburanti ose nga substanca të rrezikshme dhe helmuese në Shqipëri do të koordinohet nga QNOD-ja. Përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për mjedisin në QNOD, pranon rolin e Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar (paragrafi 2.30) dhe do të vërë në dijeni Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, ministrin përgjegjës për sektorin hidrokarbur, ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

5.3 Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar do të ndihmohet nga Skuadra për Menaxhimin e Incidentit dhe do të mbështetet nga një Komitet Teknik. Një skuadër konsulentësh do të ndihmojë Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar në disa drejtime specifike siç janë këshilla ligjore,

marrëdhëniet me median, siguria etj. Në rastin e një incidenti madhor me ndotje detare, për vendime të rëndësishme ekonomike dhe politike, Këshilli i Ministrave me propozimin e drejtorit administrativ të QNOD-së mund të vendosë të krijojë një Komitet Ndërminstrosor për Menaxhimin e Emergjencave.

5.4 Me qëllim që të kryhet një reagim sa me efektiv ndaj incidenteve me ndotje detare dhe për të ndërmarrë në mënyrë sa me efektive detyra të ndryshme, do të krijohen katër grupet funksionale, që këtej e tutje do të quhen grupet reaguese, të cilat krijohen në rastet e incidenteve të shkallës 3. Pjesë përbërëse të grupeve reaguese janë: grupi i planifikimit, grupi operativ, grupi logjistik, si dhe grupi i financës dhe administrativ, të cilët kanë përgjegjësi saktësisht të përcaktuar.

5.5 Grupe të njëjta reagimi mund të krijohen, gjithashtu, si nevojë përgjegjëse për menaxhimin e incidenteve të shkallës 2 dhe shkallës 1.

5.6 Diagramet që tregojnë strukturat drejtuese dhe menaxhuese të sistemit të reagimit kombëtar shqiptar ndaj ndotjes detare, janë pasqyruar në shtojcën 12 (për reagimin në shkallën 3) dhe shtojcën 13 (për reagimin në shkallën 2).

#### Roli i Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)

5.7 Në shkallën 3, dhe nëse është e nevojshme shkallën 2 të incidenteve me ndotje detare, QNOD-ja luan një rol drejtues dhe paraqet një platforme për bashkëpunimin midis institucioneve që kanë interesat e tyre në det, në përshtatje me misionin e saj për planifikimin, organizimin dhe drejtimin e operacioneve detare në territorin detar shqiptar. Përveç detyrave dhe përgjegjësive përshkruar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 954, datë 30.9.2009 (shiko aneksin 4) në rast të një incidenti me ndotje detare, QNOD-ja nën drejtimin e Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar do të garantojë:

- koordinimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit;
- përdorimin e integruar të rezervave kombëtare;
- koordinimin me institucionet dhe shërbimet që marrin pjesë në Qendër, të cilat janë:
  - Ministria e Brendshme (Policia Kufitare, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin);
  - Ministria e Mbrojtjes (Forca Detare dhe Marina);
  - Ministria e Financës (Doganat);
  - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
  - Ministria e Punëve Publike dhe Transportit;
  - Ministria e Bujqësisë, ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
  - Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve;
- koordinimin me Drejtorinë e Përgjithshme Detare;
- Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (ministria përgjegjëse për sektorin energjetik hidrokarbur);
  - bashkëpunim efektiv institucional;
  - shkëmbim informacioni;
  - grumbullimin e informacionit;
  - përdorimin e sistemit të integruar i vëzhgimit të hapësirës detare (SIVHD) për monitorimin e vazhdueshëm të zonave të ndikuara nga ndotja.

5.8 Në veçanti, QNOD-ja përqendron komunikimet në lidhje me incidentin, për të garantuar bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimeve të gjithë institucioneve dhe shërbimeve që marrin pjesë në Qendër dhe që operojnë në fushën e detarisë, dhe vepron si Qendër Operative për Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar, Koordinatorit Kombëtar në Terren dhe skuadrën e menaxhimit të incidentit.





#### Skuadra e menaxhimit të incidentit

5.9 Në rastet e ndotjes detare që kërkon reagimin në nivel kombëtar, QNOD-ja krijon një skuadër për menaxhimin e incidentit. Nëse do të vërehet e nevojshme, nga Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar, do të thërritet skuadra e menaxhimit të incidentit, e cila mund të veprojë në mbështetje të operacioneve reaguese të shkallës 1 dhe 2.

5.10 Roli kryesor i skuadrës për menaxhimin e incidentit është mbështetja e Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar në menaxhimin e operacionit të reagimit nëpërmjet një koordinimi më të mirë të agjencive të përfshira. Skuadra e menaxhimit të incidentit është një sistem elastik që u bën të mundur institucioneve të ndryshme të përmbushin detyrimet e tyre, pa modifikimin e nevojshëm të procedurave të brendshme operacionale.

5.11 Skuadra për menaxhimin e incidentit është e përbërë nga personat e mëposhtëm, megjithatë disa nga stafi i QNOD-së mund të luajnë më shumë se një rol:

- drejtuesi në terren (oficeri i shërbimit të QNOD-së ose oficeri drejtues i (Forcës Detare);
- përfaqësues të tjerë nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare;
- një përfaqësues i Forcës Detare (Drejtuesi i Rojës Bregdetare);
- një përfaqësues i Departamentit të Policisë Kufitare dhe Migracionit (Drejtori i Shërbimeve Operacionale);
- një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në Ministrinë e Brendshme (Drejtori i Përgjithshëm i Emergjencave Civile ose Drejtori Rajonal i Emergjencave Civile);
- një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për mjedisin (Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
- një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- një përfaqësues i drejtorisë së Përgjithshme që mbulon sektorin energjetik hidrokarbur, (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, që është një institucion në vartësi të METE);
- një përfaqësues i Inspektoratit Qendror Teknik, që mbulon çështjen e sigurisë dhe teknologjisë për sektorin hidrokarbur;
- një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik në nivel qarku ose rrethi;
- drejtuesit e katër grupeve të reagimit (paragrafi 5.4) do të bashkëzgjidhen sipas nevojës brenda skuadrës për menaxhimin e incidentit.

5.12 Skuadra për menaxhimin e incidentit drejtohet nga Koordinatori i Kombëtar në Terren, i cili emëron nënkryetarin e skuadrës për menaxhimin e incidentit duke u bazuar sipas rastit konkret.

5.13 Skuadra për menaxhimin e incidentit është përgjegjëse për vendimet politike dhe detyrat e saj janë si më poshtë:

- t'i japë Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar gjithë ndihmën e nevojshme;
- të verë në zbatim planin;
- të vlerësojë rrezikun dhe të vendosë për masat që duhen marrë për zvogëlimin e efektit të ndotjes detare;
- të vendosë për vënien në funksionim të mjeteve, pajisjeve dhe personelit për të luftuar, zvogëluar dhe eliminuar pasojat e ndotjes detare;
- të autorizojë përdorimin e dispersantëve;
- të marrë parasysh dhe të kërkojë asistencë, kur është e nevojshme, nga shtetet fqinje dhe nga REMPEC nëpërmjet autoriteteve kombëtarë kompetente;
- të monitorojë caktimin e detyrave;
- të përgatisë planin financiar dhe të kujdeset për funksionimin e tij;
- të menaxhojë marrëdhëniet me publikun;
- të vendosë ndërprerjen e aktiviteteve operacionale reaguese;

- të vendosë mbi ndërprerjen e funksionimit të planit dhe përfundimin e operacioneve reaguese; dhe

- të rishikojë dhe të përditësojë planin.

Komiteti Ndërmintor për Menaxhimin e Emergjencës

5.14 Në varësi të shkallës së emergjencës, në rastet e një incidenti me ndotje masive detare, Këshilli i Ministrave, pas propozimit të drejtorit administrativ të QNOD-së mund të vendosë krijimin e një Komiteti Ndërmintor për Menaxhimin e Emergjencës të përbërë nga anëtarë të nivelit të lartë të institucioneve të përfshira në operacionet e reagimit. Roli i Komitetit do të jetë të analizojë situatën dhe të marrë vendime të rëndësishme ekonomike dhe politike.

5.15 Gjithsesi zbatimi i vendimeve të tilla është përgjegjësia e Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar.

Komiteti teknik

5.16 Komiteti teknik është një trup këshillimor pranë skuadrës për menaxhimin e incidentit, dhe si pasojë e Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar. Komiteti teknik nuk është pjesë organizative e ndonjë ministrie apo institucioni, dhe vepron si një grup pune i përkohshëm i themeluar nga QNOD-ja me qëllimin për të ndihmuar Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar në zhvillimin dhe përditësimin e planit dhe në koordinimin e aktiviteteve përkatëse kombëtarë apo ndërkombëtare. Gjatë operacioneve të reagimit në shkallën 3 Komiteti Këshillon Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar dhe skuadrën për menaxhimin e incidentit në çështjet teknike në varësi të fushës së ekspertizës. Nëse do të vërehet e nevojshme nga Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar, Komitetit Teknik mund t'i kërkohet për të dhënë këshilla personave/autoriteteve përgjegjëse për planëzimin dhe kryerjen e operacioneve reaguese të shkallës 1 dhe 2.

5.17 Komiteti teknik është i përbërë nga ekspertë teknikë të ministrive, administratave, organizatave, ndërmarrjeve publike, private dhe shkencore dhe institucionet e tjera përkatëse, të cilat kanë njohuri të provuara në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme të ekspertizës:

- kimi/toksikologji;
- emergjencat civile;
- mbrojtje civile/mbrojtja/siguria;
- sigurisë dhe menaxhimit të krizave (kur situata del jashtë kontrollit) në sektorin hidrokarbur;

- menaxhimi i zonës bregdetare;
- çështjet e ambientit dhe mbrojtjes mjedisore;
- kujdesi shëndetësor;
- biologji marine/ruajtja e kafshëve të egra;
- reagimi i ndotjes detare;
- meteorologji/oqeanografi fizike;
- lundrim/siguri detare;
- motorët e anijeve/ndërtimin e anijeve;
- menaxhimi i mbeturinave;
- çështjet e teknologjisë së kërkimit dhe prodhimit të naftës e nënprodukteve të saj;
- çështjet e teknologjisë së depozitimit dhe transportimit të naftës dhe nënprodukteve të saj.

5.18 Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar emëron Drejtorin dhe Nëndrejtorin e Komitetit Teknik rast pas rasti.

5.19 Madhësia dhe struktura e Komitetit mund të ndryshojë në varësi nga situata konkrete dhe nevojës për ekspertizë nga Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar dhe skuadra për menaxhimin e incidentit. Ekspertë shtesë (p.sh., nga universitetet, industria e naftës dhe kimikateve, portet, kantieret detare etj.) mund të bëhen pjesë e Komitetit, të cilët kërkohen duke pasur parasysh madhësinë, kompleksitetin dhe parashikimin e ndikimit mjedisor dhe ekonomik të këtij incidenti specifik me ndotje detare.



5.20 Ekspertë të jashtëm nga p.sh.: REMPEC, IOTPF, Fondi IOPC, IMO, EMSA dhe KE mund të ftohen, nëse do të jetë e nevojshme, të marrin pjesë në punën e Komitetit.

Grupet e reagimit

5.21 Katër grupet e reagimit të përcaktuara në paragrafin 5.4 janë në varësi të koordinatorit në terren si drejtuesi i skuadrës për menaxhimin e incidentit, për drejtimin e operacioneve, funksioneve ndihmëse dhe administrimit të strukturës komanduese.

5.22 Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të grupeve të reagimit janë përcaktuar si më poshtë:

Grupi i operimit

5.23 Grupi i operimit i raporton Koordinatorit Kombëtar në Terren dhe në konsultim të ngushtë më të është përgjegjës për kryerjen e operacioneve kundër ndotjes.

5.24 Grupi i operimit është përgjegjës për:

- koordinimin me Koordinatorit Kombëtar në Terren për taktikat në luftën kundër ndotjes në det;

- përcaktimin e nivelit të burimeve plotësuese të kërkuara, bazuar në kërkesën e bërë nga grupi i planëzimit, si dhe prioritetet e përcaktuar nga Koordinatori Kombëtar në Terren;

- koordinimin me grupin e planifikimit mbi prioritet për mbrojtjen e vijës bregdetare, bazuar në vendimet e Koordinatorit Kombëtar në Terren;

- rekomandimin e burimeve nga rezervat shtesë të nevojshme për luftën kundër ndotjes në det dhe mbrojtjes së vijës bregdetare dhe informimin e grupit logjistik;

- me mbërritjen e naftës në breg, koordinimin e punës me skuadrën e menaxhimit të operacionit, si dhe Koordinatorit Kombëtar në Terren në lidhje me strategjinë e pastrimit;

- përcaktimin e nivelit të rezervave shtesë të nevojshme për pastrimin e vijës bregdetare, duke identifikuar burimin(et) dhe instruktimin nga grupi logjistik;

- monitorimin e progresit të operacioneve. Në fundin e çdo dite, të vlerësojë punën e kryer dhe në bashkëpunim me grupin e planifikimit, të përpilojë një plan veprimi për incidentin dhe dhënien për miratim Koordinatorit Kombëtar në Terren;

- të udhëzojë Koordinatorin Kombëtar në Terren mbi drejtimin dhe progresin e operacioneve, duke përfshirë mungesat e rezervave;

- të koordinojë ngushtësisht me grupin e planifikimit gjatë gjithë operacionit;

Grupi i planifikimit

5.25 Grupi i planifikimit i raporton Koordinatorit Kombëtar në Terren dhe është përgjegjës për vlerësimin e ndotjes, planifikimin e operacioneve dhe përpilimin e plan veprimit ditor mbi incidentin. Koordinon punën me skuadrën e menaxhimit të incidentit (Koordinatorit Kombëtar në Terren) dhe me grupet operacionale.

5.26 Grupi i planifikimit është veçanërisht përgjegjës për:

- Caktimin e vijës bregdetare, anijes dhe mbikëqyrjes ajrore, për të konstatuar pozicionin, shtrirjen, lëvizjen dhe sasinë e ndotjes.

- Vlerësimin e nivelit të rezervave të nevojshme, për të gjitha çështjet mjedisore, duke u përqendruar në ndjeshmërinë e vijës bregdetare të prekur, prioritetet për mbrojtjen e vendeve të ndjeshme dhe efektin mjedisor të metodave të pastrimit;

- Vlerësimin e nivelit të rezervave të nevojshme në luftën kundër ndotjes, në bashkëpunim me grupin e operimit;

- Të mundësojë këshilla, sipas kërkesës, për të gjitha çështjet mjedisore në lidhje me ndjeshmërinë e vijës bregdetare të prekur, prioritetet e vendeve të ndjeshme dhe efekti mjedisor i metodave të pastrimit;

- Të bëjë vlerësimin e ndikimit mjedisor në rast së incidenti zgjeron përmasat, për njoftimin e Koordinatorit Kombëtar në Terren, dhe grupit të operimit, si dhe përfshirjen e mundshme në informimin e medias;

- Të veprojnë si koordinator me grupet e interesuar ambientaliste (p.sh. skuadra për mbrojtjen e kafshëve të egra, për pastrimin e zogjve etj.);

- Përcaktimin e një menaxheri salle për të garantuar transmetimin e mesazheve brenda dhomës/qendrës drejtuese të incidentit, duke garantuar transmetimin e duhur të informacioneve në bord dhe garantimin që të mos neglizhohen veprimet e lëna pezull;

- Mbajtjen e rekordeve treguese dhe mbështetëse të gjithë aktiviteteve në lidhje me ndotjen;

- Llogaritjen dhe përditësimin e tabelave informative dhe hartave operacionale;

Grupi logjistik

5.27 Grupi logjistik i raporton Koordinatorit Kombëtar në Terren mbi prokurimet dhe çështjet logjistike dhe koordinon ngushtësisht me grupin e operimit mbi detyrat specifike të përcaktuara.

5.28 Grupi logjistik është veçanërisht përgjegjës për:

- konstatimin e mundësisë dhe shpenzimeve financiare të rezervave shtesë të kërkuara nga grupet operacionale dhe planifikuese

- përgatitjen e formularëve standard për kontratat e marrjes me qira të mjeteve dhe pajisjeve të tjera;

- kur miratohet nga Koordinatorit Kombëtar në Terren, të kryejë marrëveshje të nevojshme për;

- prokurimin nga furnizuesit e mjeteve të kërkuara;

- dërgimin e mjeteve në vendin e incidentit.

- monitorimin e niveleve të rezervave të vendosura në vende të ndryshme dhe përditësimin e tabelave informative në dhomën e incidentit;

- duke u konsultuar me grupet operacionale dhe grupin e planifikimit, të rivendosë pajisjet/mjetet kur ato e kalojnë sasinë e nevojshme në vende të ndryshme;

- rikthimin e mjeteve dhe rezervave të marra me qira kur Koordinatori Kombëtar në Terren vendos që ato nuk nevojiten më;

- marrjen e masave për inspektimin e gjendjes së mjeteve të marra me qira (bashkë me provat fotografike) para se t'u kthehen pronarëve;

- të mundësojë furnizimin me ushqim të stafit të dhomës/qendrës së drejtimit të incidentit;

- sigurimin, veçanërisht të kontrollit të hyrjes në dhomën/qendrën e drejtimit;

- mundësimin pajisjeve dhe lidhjeve të komunikimi;

- organizimin e operatorëve telefonik në qendrën e drejtimit të incidentit.

Grupi i financës dhe administrimit

5.29 Grupi i financës dhe administrimit i raporton Koordinatorit Kombëtar në Terren mbi të gjitha çështjet financiare dhe administrative dhe koordinon ngushtësisht me grupin logjistik.

5.30 Grupi i financës dhe administrimit është veçanërisht përgjegjës për:

- monitorimin e shpenzimeve gjatë operacioneve reaguese ndaj incidentit

- sistemimin e faturave me shpenzimet për të mbështetur pretendimet për kompensim të bëra ndaj siguruesve;

- dhënien e këshillave përkatëse Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Koordinatorit Kombëtar në Terren mbi çështjet e kompensimit;

- mbajtjen e rekordeve të gjitha shpenzimeve të kryera, duke përfshirë pretendimet për kohën e stafit;

- koordinimin me përgjegjësën administrativ në vendin e incidentit në lidhje me shpenzimet e kryera nga skuadra e reagimit në terren;

- t'i paraqesë Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Koordinatorit Kombëtar në Terren një përmbledhje ditore të shpenzimeve të kryera;

- dhënien e ndihmës QNOD-së në administrim;



- të mbajë një fotokopje dublikate të gjithë korrespondencës së ardhur dhe dërguar (fakse, e-mail, letra) duke i paraqitur në mënyrë kronologjike;

- të mundësojë mbështetje sekretarie grupeve të tjera.

5.31 Në disa rrethana, veçanërisht për ndotje jo shumë të mëdha, Koordinatori Kombëtar në Terren mund të vendosë kombinimin e funksioneve logjistike, të financës dhe administrimit, duke parë që këto grupe do të punojnë shumë afër njëri-tjetrit.

Akomodimi

5.30 QNOD-ja siguron që akomodimi për çdo grup të ketë linja telefoni të mjaftueshëm për të garantuar koordinimin me grupet e tjera të jashtme, lidhje interneti të shpejtë, kompjuterë, një fotokopjues dhe një makine faksi, si dhe sipërfaqe muri të mjaftueshëm për shfaqjen e diagrameve të ndryshme dhe tabelave mbi situatën. Nëse është e mundur, çdo grup, duhet të pajiset me një pajisje VHF fiks, pajisje TV dhe video.

## 6. MËNYRAT E REAGIMIT

6.1 Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar ka të drejtën ligjore të ndërmarre të gjitha veprimet e përshtatshme dhe të nevojshme për të pastruar dhe/ose zvogëluar ndikimin e ndotjes detare nga nafta ose lënda e rrezikshme dhe helmuese. Për përcaktimin e mënyrës së përshtatshme të reagimit në çdo rrethanë, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar do të marrë parasysh mënyrat e posaçme që prodhojnë rezultate mjedisore më të pranueshme.

6.2 Plani bën dallimin ndërmjet reagimit ndaj ndotjes nga nafta me ato të ndotjes nga lëndët e tjera të rrezikshme dhe helmuese.

## 7. REAGIMI NDAJ NDOTJES DETARE TË SHKAKTUAR NGA NAFTA

7.1 Reagimi ndaj një derdhje madhore do të kryhet sipas vendimit të Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar. Në ndërmarrjen e këtij vendimi Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar duhet të ketë parasysh mënyrat e mëposhtme të reagimit:

- monitorimin;

- eliminimin e burimit të ndotjes;

- operacionet e reagimit në det, duke përfshirë kontrollin dhe mbledhjen e karburantit të derdhur dhe shpërndarjen kimik të tij;

- operacionet e reagimit në breg – pastrimi i vijës bregdetare; dhe

- hedhja e materialit vajor të mbledhur.

7.2 Bashkë me vendimin mbi reagimin ndaj një incidenti me ndotje, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar ndërmerr, gjithashtu, masa, ose t'i kërkojë autoriteteve të tjera kompetente të ndërmarrin masa me qëllim që:

- të sigurojë zonat e ndotura nga veprimet dhe hyrjet e paautorizuara;

- garantojë marrjen pa pengesa të mostrave të ujit të detit dhe, nëse do të jetë e nevojshme, monitorimin e cilësisë së ajrit;

- të ndalojë aktivitetet e peshkimit në zonat e ndotura, nëse do të jetë e nevojshme;

- të ndalojë lundrimin dhe fluturimin mbi zonën e ndotur, sipas nevojës.

Monitorimi

7.3 Sipas planit aktual monitorimi ndahet në modeli 1 (monitorim operacional, vëzhgim i rrjedhjes) ose modeli 2 (monitorim jooperacional/shkencor). Modeli 1 mundëson informacion në lidhje direkt me operacionin e reagimit ndaj derdhjes, dhe zakonisht i referohet monitorimit të mbledhjes së shpenzimeve para ndërprerjes së reagimit. Modeli 2 përfshin çdo monitorim mjedisor që ndërmerret për qëllime të ndryshme nga ato për drejtimin e një reagimi ndaj derdhjes, dhe zakonisht kryhet pasi reagimi të ketë përfunduar. Ky monitorim do të kryhet sipas një marrëveshje paraprake me shkaktarin e ndotjes apo Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

7.4 Fillimi i monitorimit operacional (mbikëqyrjes së derdhjes) do të jetë veprimi i parë që do të kryhet para ose gjatë fazës së reagimit aktiv.

7.5 Monitorimi operacional (mbikëqyrja e ndotjes) mund të jetë veprimi i vetëm i nevojshëm dhe një alternative e reagimi ligjor në rrethana të veçanta, kur varet në tipin dhe volumin e karburantit, vendin dhe kushteve klimaterike, reagimi me efektiv mund të jetë lejimi i përhapjes natyrale të karburantit.

7.6 Nëse ndonjë veprim i mëtejshëm do të nevojitet, monitorimi i operacionit në vazhdim (mbikëqyrjes së derdhjes) do të kryhet për të vlerësuar suksesin e aktiviteteve të reagimit. Çdo shpenzim i arsyeshëm në lidhje me këtë monitorim do të përfshihet në mënyrë ligjore në reagim dhe do të dëmshpërblehet plotësisht nga ndotësi.

7.7 Monitorimi operacional (mbikëqyrje e ndotjes) shërben për të vlerësuar situatën aktuale në rastet e ndotjes detare. Ajo përfshin mbikëqyrjen detare (mbledhja e mostrave) dhe mbikëqyrje ajrore (nga avionë, helikopter ose me satelit) për ndotjet në det, dhe vendosjen e skuadrës vlerësuese të pastrimit të vijës bregdetare për ndotjen në breg.

7.8 Modeli 2 i monitorimit mund të jetë i nevojshëm për rikthimin në gjendjen e mëparshme të mjedisit pas ndodhjes së derdhjes. Ajo në fillim do të përfshijë hetimin për një rikthim të mundshëm, dhe përcaktimin ku rikthimi ka arritur një nivel të mjaftueshëm për përfundim. Modeli 2 i monitorimit përfshin, gjithashtu, vlerësimin e efekteve mjedisore afatgjata pas derdhjes.

Analizat e situatës dhe ndikimi mjedisor

7.9 Analizat e situatës dhe vlerësimi i impaktit mjedisor janë bërë mbi bazat e informacionit fillestar të incidentit me ndotje (siç u përcaktua në seksionin 4), të dhënat e mbledhura nga monitorimi operacional dhe të dhëna të tjera përkatëse si të dhënat historike, pronat e karburantit, parashikimi, rryma dhe të dhënat e erës, kushtet e detit, ndjeshmëria e detit, vlerësimi i rrezikut dhe modelimi në kompjuter i trajektores së karburantit.

7.10 Në momentin që Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar dhe skuadra e menaxhimit të incidentit kanë mbledhur të gjitha të dhënat e mundshme dhe, bazuar në ato të dhëna kanë bërë dhe analizën e situatës, ata vendosin mbi mënyrat e reagimit, vendet e strehimit dhe shpëtimin.

Reagimi në det

7.11 Në rastet kur lënda ndotëse është akoma në rrjedhje, në më të shumtën e rasteve mund të jetë e preferueshme të lejohet karburanti të dalë në breg. Prioritet i duhet dhënë ndalimit të lëndës ndotëse të përhapet në zonat bregdetare të ndjeshme.

7.12 Reagimi në det përfshin:

- shpërndarjen natyrale nëpërmjet erës dhe veprimeve të valës, e shoqëruar me mbikëqyrjen e derdhjes.

- përdorimi i shpërndarësve kimike;

- devijim ose kontrollin me shirita kufizues;

- mbledhjen e karburantit të derdhur duke përdorur aparat ndarës/pompa dhe depozita të përkohshme në bord.

7.13 Reagimi në det varet nga vendndodhja e lëndës ndotëse dhe është i ndarë në tri lloje të ndryshme reagimi.

7.14 Reagimi te burimi i ndotjes (eliminimi i burimit të ndotjes) përmban si vijon:

- stabilizimin e anijes;

- ndalimin dhe reduktimin e derdhjes jashtë të lëndës ndotëse;

- transferimin e lëndës ndotëse në bordin e anijes dhe/ose transferimin e lëndës në ndonjë anije tjetër (lehtësimin e anijes);

- shpërbërjen kimike të lëndës ndotëse;

- kontrollin e lëndës ndotëse me shirita kufizues;

- mbledhjen e lëndës ndotëse duke përdorur aparat ndarës/pompa dhe depozitimin e përkohshëm të saj në bord.

7.15 Reagimi në det të hapur përfshin si më poshtë:

- shpërbërjen kimike të lëndës ndotëse;



- kontrollin e lëndës ndotëse me shirita kufizues;
- mbledhjen e lëndës ndotëse duke përdorur aparat ndarës/pompa dhe depozitimin e saj të përkohshëm në bord;
- përdorimin e sorbenteve (solucione absorbuuese), mbledhjen duke përdorur barka peshkimi (rrjeta) sipërfaqësore dhe depozitimin e përkohshëm të mbetjeve në bord;

7.16 Reagimi afër vijës bregdetare përfshin si më poshtë:

- mbrojtja e zonave të ndjeshme në breg duke përdorur shirita kufizues
- devijimin e njollës së karburantit në drejtim të zonave me ndjeshmëri të ulët;
- kontrollin dhe mbledhjen e lëndës ndotëse; dhe
- tretjen e kujdesshme të lëndës ndotëse nga shpërndarja e kufizuar e shpërbërësve nën kontrollin e ekspertëve ekologjikë.

Përdorimi i shpërbërësve kimikë

7.17 Nëse mbledhja mekanike e karburantit dhe/ose përzierjes së karburantit të derdhur nuk është e mundur mund të përdoren shpërbërës për ta mbledhur karburantin e derdhur nga sipërfaqja e detit.

7.18 Vetëm Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar mund të autorizojë përdorimin e shpërbërësve në rastet e reagimit të shkallës 3. Në rastin e reagimit të shkallës 2, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar mund ta delegojë të drejtën për autorizimin e përdorimit të shpërbërësve Koordinatorit Kombëtar në Terren ose oficerit komandues të Rojës Bregdetare përkatës.

7.19 Në mungesë të rregulloreve të plota kombëtare në lidhje me përdorimin e shpërbërësve gjatë reagimit ndaj ndotjeve nga nafta apo lëndë të rrezikshme dhe helmuese në detin territorial shqiptar, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar (ose Koordinatori Kombëtar në Terren ose oficerit komandues të rojës bregdetare përkatëse), në incidente specifike mund të autorizojë përdorimin e shpërbërësve nëse produkti i planifikuar për t'u përdorur është aprovuar për përdorim nga autoritetet kombëtare (mjedisore) kompetente. Këto autoritete kompetente mund ta miratojnë përkohësisht përdorimin në detin territorial të Republikës së Shqipërisë të produkteve të miratuara për përdorim nga një shtet tjetër që ka karakteristika të njëjta oqeanografike dhe ekologjike me atë të Shqipërisë.

7.20 Kriteri për dhënien e miratimit për përdorimin e shpërbërësve në detin territorial shqiptar do të marrë në konsideratë, së pari, efikasitetin e produktit dhe, së dyti, shkallën e dëmit. Testimi dhe miratimi i produkteve do të ndërmerret nga një laborator publik i autorizuar. Procedura për miratimin dhe testimin e produkteve të trajtimit të karburantit janë dhënë në shtojcën 14.

7.21 Përdorimi i shpërbërësve nuk do të autorizohet në:

- zonat natyrore të mbrojtura / zonat detare me ndjeshmëri të veçantë;
- kulturë detare (kultivimi i peshkut dhe i butakëve);
- zonat e shumëzimit të peshqve;
- zona ku, nën influencën e baticave, erërave e niveleve të ulëta detare, është i mundshëm kthimi i ujit të detit në lumenj ose laguna bregdetare.

7.22 Përdorimi i shpërbërësve nuk do të autorizohet në zona të detit territorial shqiptar ku thellësia është më pak se 20 metra dhe ku nuk ka erë dhe rrymë të mjaftueshme.

7.23 Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar (ose Koordinatori Kombëtar në Terren ose oficerit komandues i rojës bregdetare përkatëse) vendos mbi përdorimin e shpërndarësve duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat ekzistuese (llojin e lëndës ndotëse, kushtet hidro-meteorologjike, mundësinë e mjeteve dhe personelit etj.).

7.24 Është përgjegjësia e QNOD-së të:

- ndërmarrë një analizë përfutuese mjedisore të rrjetit (NEBA) për të specifikuar zonat ku përdorimi i shpërbërësve është i para autorizuar ose kategorikisht i ndaluar; dhe
- zhvillimin e një politike kombëtare mbi përdorimin e shpërbërësve.

7.25 Lista e zonave në të cilat përdorimi i shpërbërësve është i para autorizuar, ndaluar ose mund të autorizohet në kushte të veçanta, do të raportohet dhe paraqitet si një hartë/ seri hartash në shtojcën 15.

Reagimi në vijën bregdetare

7.26 Në momentin që ndotja ka prekur bregun, impakti mjedisor zakonisht është më i lartë dhe pastrimi është me kompleks, harxhon më shumë kohë dhe shpenzime sesa kur reagimi kryhet gjatë kohës që ndotja është në det.

7.27 Reagimi në vijën bregdetare përfshin:

- parapastrim (përmirësimin e ndërhyrjes dhe reduktimin e mbetjeve);
- pastrimin mekanik dhe/ose manual;
- mbledhjen dhe ruajtjen e përkohshme të lëndës së grumbulluar në tokë; dhe
- rehabilitimi biologjik (duke përdorur organizma të gjalla për përshpejtimin e degradimit të karburantit). Theksohet se rehabilitimi biologjik nuk mund të konsiderohet si një metode/teknikë standarde për pastrimin e bregdetit.

7.28 Në rastet e ndotjes së vijës bregdetare nga karburanti Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar vendos, duke u konsultuar me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, mbi metodën dhe qëllimin e operacioneve të pastrimit, duke marrë parasysh të dhënat e mbledhura nga një skuadër vlerësuese për pastrimin e vijës bregdetare e vendosur në vijën bregdetare të ndotur, duke përfshirë ndër të tjera:

- karakteristikat dhe tipin e vijës bregdetare;
- ndjeshmërinë e ekosistemit dhe karakteristikat biologjike të vijës bregdetare;
- llojin dhe sasinë e karburantit në breg;
- stinën e vitit dhe kushtet hidro-metereologjike;
- infrastrukturën ekzistuese në breg dhe mundësinë për vendosjen e materialit të mbledhur;

7.29 Me qëllimin për të garantuar konsistencën dhe homogjenizimin e të dhënave të mbledhura gjatë vëzhgimit të vijës bregdetare të ndotur, SVPVB do të përdorë formularin e vlerësimit të vijës bregdetare të përcaktuar në shtojcën 16.

7.30 Metoda dhe qëllimi i pastrimit duhet të marrë në konsideratë, gjithashtu:

- kohën e kaluar nga derdhja e karburantit në det;
- dëmtimet e mundshme të mjedisit dhe ekonomisë bregdetare në rast pastrimi me shpërndarës kimik të karburantit.

7.31 Para fillimit të aktiviteteve të pastrimit të vijës bregdetare, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar (ose Koordinatori në Terren, ose prefekti i qarkut përkatës ose oficeri komandues i Rojës Bregdetare përkatëse) duhet të garantojë që:

- burimi i ndotjes është eliminuar;
- përhapja e mëtejshme e ndotjes detare është kufizuar;
- është vendosur një skuadër vlerësimi për pastrimin e vijës bregdetare në zonat e ndotura;
- është bërë e mundur mbrojtja maksimale për gjithë personat e përfshirë në pastrimin e bregut;
- zona bregdetare e prekur është bërë gati për operacionin e pastrimit;
- janë vendosur skuadrat e ndërhyrjes dhe detyrat e pastrimit janë organizuar;
- të bëhet transporti për personelin, mjeteve teknike dhe materialit të mbledhur, dhe nëse është e nevojshme, akomodimi dhe ushqimi për personelin e përfshirë në operacionet e pastrimit;
- të jetë përcaktuar dhe rënë dakord për venddepozitimin e përkohshëm dhe final për materialin e mbledhur.

7.32 Në reagimin në shkallën 2 përgjegjësinë për organizimin dhe kontrollin e operacioneve të pastrimit të bregut e ka prefekti i qarkut, në bashkëpunim me mbrojtjen civile dhe bashkitë/komunat dhe me asistencën e institucioneve të tjera të përfshira.





7.33 Në reagimin në shkallën 3, përgjegjësinë për organizimin dhe kontrollin e operacioneve të pastrimit të vijës bregdetare e ka QNOD-në në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe me asistencën e institucioneve të tjera që kanë interesat e tyre në det, nën drejtimin e përgjithshëm të Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar.

7.34 Në momentin që prefekti i qarkut apo Koordinatori në Terren e konsideron që pastrimi i mëtejshëm është joefektiv, ai lajmëron Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar, i cili vendos pas konsultimit me skuadrën e menaxhimit të incidentit dhe Komitetin Teknik, për të përfunduar pastrimin e vijës bregdetare të ndotur.

Menaxhimi i mbetjeve

7.35 Operacionet e pastrimit të ndotjes nga karburantet mund të gjenerojnë sasi të mëdha mbeturinash, të cilat duhet të hidhen në një vend mjedisor. Hedhja e mbeturinave gjatë operacioneve të reagimit ndaj ndotjes, zakonisht është veprimi më i gjatë dhe më i kushtueshëm i operacionit.

7.36 Procedurat për transportin, dorëzimin, trajtimin dhe hedhjen e karburantit, mbeturinat dhe materialet me karburant duhet të jetë në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

7.37 Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe autoritetet lokale, janë përgjegjëse për të gjitha operacionet dhe procedurat në lidhje me hedhjen e mbeturinave. Kujdes të veçantë duhet të bëhet nga të gjithë ata që kanë lidhje me respektimin rigoroz të rregulloreve përkatëse mbi përpunimin dhe hedhjen e mbeturinave.

7.38 Ministria përgjegjëse për mjedisin duhet të përcaktojë paraprakisht, jo më vonë se një vit pas miratimit të këtij plani, vende potenciale depozitimi për mbeturinat e karburantit në lokalitete të ndryshme përgjatë bregut. Një hartë që tregon vendosjen e këtyre vendeve, do t'i bashkëngjitet planit në shtojcën 17.

7.39 Ministria përgjegjëse për ambientin, duhet të përcaktojë pajisje brenda shtetit që mund të bëjnë përpunimin paraprak dhe të përpunojë mbeturinat vajore, dhe të marrë parasysh marrëveshjet e bëra me pronarët e tyre për përdorimin e shërbimit të tyre në rast ndotjeje të detit.

7.40 Ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me prefektin e qarkut, duhet të marrë parasysh zhvillimin dhe/ose mirëmbajtjen e planit kombëtar për menaxhimin e mbeturinave nga rrjedhja e karburantit (PKMMDK) me qëllimin për të menaxhuar mbeturinat vajore në një mënyrë efikase dhe minimizimin e mbeturinave të krijuara nga operacionet e reagimit, duke pasur parasysh ndër të tjera (përzgjedhjen e burimit, riciklimin, ripërdorimin, ruajtjen e përkohshme dhe afatgjatë, transferimet, përpunimet (paraprake) dhe depozitimin përfundimtar).

Reagimi për kafshët e egra

7.41 Qëllimi i reagimit për shpëtimin e kafshëve të egra është shmangja, shërimi, zvogëlimi dhe/ose monitorimi i çdo ndikimi të dëmshëm mbi kafshët e egra gjatë operacioneve të reagimit ndaj ndotjes detare.

7.42 Ndërsa Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar është drejtpërdrejt përgjegjës për garantimin e ekzistencës së një reagimi të besueshëm dhe efektiv për kafshët e egra, nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare të specializuara do të mundësohet ekspertizë specifike shtesë. Brenda një viti pas miratimit të këtij plani institucionet e përcaktuara duhet të zhvillojnë një plan reagimi të përshkallëzuar për kafshët e egra duke marrë parasysh udhëzimet ndërkombëtare dhe vendosjen e një objekti kombëtar për kapacitetet trajtuese të kafshëve të egra, duke përfshirë personelin dhe mjetet që nevojiten për përdorim gjatë reagimit nga derdhja.

7.43 Reagimi për kafshët e egra, kur është e mundur, do t'u përmbahet protokolleve të praktikave më të mira të standardeve ndërkombëtare, duke i dhënë prioritet sigurisë njerëzore, gjithashtu, dhe mirëqenies së kafshëve. Në të gjitha rastet, monitorimi i shpëtimit dhe lëshimit të kafshëve të egra janë një komponent integral i procesit të rehabilitimit, duke siguruar mbështetje për përmirësimin e efikasitetit të operacioneve në të ardhmen.

7.44 Kur pas ndotjes së mjedisit nuk merret ndonjë masë konkrete për mbledhjen e ndotësit, reagimi për shpëtimin e kafshëve të egra mund të jetë aktiviteti i vetëm që do të ndërmerret.

7.45 Shpenzimet për reagimin për kafshët e egra të autorizuara nga Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar, në disa raste do të rimbursohen plotësisht nga ndotësi sipas regjimit ndërkombëtar për kompensimin e dëmit nga ndotja. Mund të ndodhë që aktivitetet reaguese ndaj ndotjes së kafshëve të egra mund të jenë akoma të nevojshme edhe pasi reagimi ndaj ndotjes mund të ketë pushuar, dhe kjo do të mbahet parasysh kur të planifikohet përfundimi i operacionit të reagimit.

## 8. REAGIMI NDAJ NDOTJES SË SHKAKTUAR NGA SUBSTANCAT E RREZIKSHME DHE HELMUESE

8.1 Nëse ndotësi identifikohet, identifikimi i lëndëve që janë shkarkuar ose që mund të shkarkohet ndërmerret në të njëjtën mënyrë si operacionet e reagimit në rastet e ndotjes nga karburantet. Kapiteni i anijes, pronari i anijes dhe pronari i mallit duhet t'i paraqesin Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar në mënyrë urgjente informacionin e saktë mbi llojin e mallit dhe pozicionit të tij në bordin e anijes.

8.2 Në varësi të pozicionit të anijes, llojit të mallit dhe kërcënimit që shfaq për shëndetin njerëzor dhe, gjithashtu, në varësi të kushteve meteorologjike, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar do të urdhërojë marrjen e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë dhe/ose nëse është e nevojshme, të kërkojë strehimin ose evakuimin, sipas nevojës, të popullatës në afërsi të incidentit.

8.3 Marrja e mostrave dhe analizat e ujit të detit, dhe nëse është e nevojshme marrja e mostrave dhe analiza e cilësisë së ajrit në zonën e ndotur, kryhet nga laboratorë publike të autorizuar në përputhje me rregullore të veçanta.

8.4 Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar mban listën e laboratorëve të autorizuar për marrjen e mostrave dhe analizën e lëndëve të dëmshme e të rrezikshme.

8.5 Lista e lëndëve të dëmshme e të rrezikshme që ka mundësi të derdhen ose lëshohen në detin territorial të Republikës së Shqipërisë është përcaktuar në aneksin 18.

8.6 Kryerja e operacioneve individuale të reagimit, ndërmerret në zbatim të udhëzimit për trajtimin e lëndëve të dëmshme e të rrezikshme, të rënë dakord nga Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar, prodhuesit dhe ekspertët në atë fushë.

8.7 Në mungese të udhëzimeve të detajuara për trajtimin e lëndëve të dëmshme e të rrezikshme, do të përdoret MIDSIS-TROCS (sistemi i informimit mbështetës i vendimit të integruar mesdhetar) versioni 2.0 ose i mëvonshëm.

8.8 Organizimi dhe menaxhimi i reagimit ndaj incidenteve që përfshijnë lëndë të rrezikshme dhe helmuese do të ndjehet të njëjtat parime si ato të përshkruara në seksionet 2, 3, 4, 5 dhe 7 të këtij plani.

## 9. VLERËSIMI I RREZIKUT

9.1 Niveli i përgatitjes ndaj ndotjes detare në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar do të bazohet mbi vlerësimin e rrezikut të ndotjes detare për pjesë të ndryshme të zotërimeve detare, gjithashtu, në ndjeshmërinë e mjedisit detar.

9.2 QNOD-ja përgatit një vlerësim të detajuar të rrezikut në nivel rajonal dhe të përfshihet në planin rajonal të emergjencës.

9.3 Vlerësimi i rrezikut duhet të përfshijë të paktën:

- përcaktimin e zonave me rrezikshmëri të lartë në lidhje me ndotjen detare (terminalet e rrugëve të anijeve çisternë dhe anijeve të tjera, portet, ankorimet, instalimet bregdetare dhe linjat e tubave nën ujë, burimet potenciale të aksidenteve me ndotje detare, anijet dhe avionët e mbytur etj.);

- vlerësimi i sasisë së derdhjes së karburanteve dhe lëndëve të rrezikshme dhe helmuese dhe efekti i tyre mbi zonat tepër të ndjeshme;

- përcaktimi i numrit dhe frekuencës së hyrjes në porte të anijeve që transportojnë karburant apo lëndë të rrezikshme dhe helmuese, përmasat e tyre dhe kapacitetet e mallrave, dhe dendësia e trafikut nga anijet e tjera;



- analizimin e të dhënave të oqeanografisë, hidrografisë dhe metereologjike;
- rekorde të incidenteve me ndotje detare të shkaktuara nga karburanti dhe lëndët e rrezikshme dhe helmuese;
- rekorde të incidenteve detare që nuk kanë shkaktuar ndotje detare;
- vlerësimin ekonomik të pasojave të ndotjeve potenciale detare.
- përcaktimin e zonave ku zhvillohen operacione kërkim-prodhimi hidrokarburesh,
- përcaktimin e platformave të shpimit ose prodhimit të naftës,
- përcaktimin e tubacioneve të transportit të naftës e nënprodukteve të saj.

9.4 Vlerësimi i rrezikut duhet të plotësohet me identifikimin e të gjitha zonave të ndjeshme që mund të ndikohen negativisht nga incidentet me ndotje detare. Këtu përfshihen zona, të cilat janë të rëndësishme për qëllimet e tyre mjedisore, tregtare, argëtuese dhe çlodhëse.

9.5 Vlerësimi i zonave të ndjeshme duhet të përfshijë të paktën:

- përcaktimin dhe planifikimin e llojit të bregdetit (balte, rëre, zhavorri shkëmbor etj.);
- listimin dhe përshkrimin e burimeve natyrore të mbrojtura dhe me ndjeshmëri;
- listimin dhe përshkrimin e burimeve të rrezikuara (duke përfshirë zonat mjedisore të ndjeshme, objektet tregtare në breg edhe në det, zonat sportive dhe çlodhëse, zonat turistike, zonat e peshkimit, zonat kulturore detare, vendet e trashëgimisë kulturore etj.);
- listën e vendeve potenciale të strehimit.

9.6 Vlerësimi i ndjeshmërisë duhet të shërbejë si bazë për përgatitjen e hartave të zonave me ndjeshmëri të bregdetit shqiptar. Harta e zonave me ndjeshmëri duhet të shfaqen në një SIG (sistem i informimit gjeografik).

9.7 QNOD-ja, përgjegjëse për garantimin e këtij vlerësimi të rrezikut, dhe vlerësimi i ndjeshmërisë së zonës bregdetare, përgatitet në bashkëpunim me administratën kombëtare kompetente për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, si dhe institucionet kombëtare përkatëse.

9.8 Një përmbledhje e vlerësimit të rrezikut dhe hartave përkatëse të zonave me ndjeshmëri do t'i bashkëngjitet këtij plani përkatësisht në aneksin 19 dhe aneksin 20.

## 10. BURIMET

### Pajisjet

10.1 QNOD-ja siguron që të gjitha institucionet shtetërore dhe subjektet private të deklarojnë paraprakisht pranë saj të gjitha mjetet (detare, ajrore etj.) dhe pajisjet që parashikohen të përdoren gjatë operacioneve të reagimit ndaj ndotjes detare.

10.2 QNOD-ja do të sigurojë që Forca Detare të zbatojë standardet e rena dakord për mirëmbajtjen menaxhimin, shpërndarjen, ruajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të nevojshme. QNOD-ja, sipas rastit, do të shpërndajë pajisje të mjaftueshme autoriteteve të zonës (rajonit), dhe sipas nevojës industrisë lokale, për reagimin ndaj rrjedhjeve të identifikuar gjatë vlerësimit të rrezikut që mund të ndodhin brenda zonave të tyre të përgjegjësisë. Kjo i jep çdo zone (rajonit) pavarësinë për të reaguar ndaj disa ndotjeve të vogla, si dhe fillimin e një reagimi fillestar ndaj incidenteve më të rëndësishme

10.3 Shpërndarja e pajisjeve behet subjekt i shqyrtimit të rregullt, duke iu referuar vlerësimit të rrezikut dhe konsultës me autoritetet rajonale dhe lokale, për garantimin e niveleve të përshtatshme dhe llojet përkatëse të pajisjeve do të përdoren në vendin e saktë. Pika e konsiderimit është fleksibiliteti dhe mundësia për t'i rishpërndarë shpejt pajisjet në mënyrë rajonale ose kombëtare.

10.4 Planifikimi për porositjen dhe zëvendësimin e pajisjeve të reja ndërmerret nga QNOD-ja, në konsultim me skuadrën e menaxhimit e operacionit, Komitetin Teknik, ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe çështjet detare (MPPT), Drejtorinë e Përgjithshme Detare, si dhe ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet (METE).

10.5 Të gjitha pajisjet e shpërndara industrisë lokale dhe autoriteteve të zonës (rajonit), qëndrojnë pronë e QNOD-së si pjesë e një inventari të pajisjeve për reagimin kombëtar ndaj rrjedhjeve të karburanteve. Kështu, ajo do të jetë në dispozicion për rishpërndarje emergjente në zona të tjera në rastet e ndonjë derdhje.

10.6 Pjesë e inventarit kombëtar të pajisjeve të reagimit, të përfshira dhe ato të shpërndara autoriteteve zonale (rajonale), mund të jepen me qira të kufizuar palëve të treta me miratimin e Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar. Edhe gjatë kohës që janë dhënë me qira, mjetet duhet të jenë në gatishmëri për shpërndarje emergjente nëse ndodh ndonjë ndotje madhore detare.

10.7 QNOD-ja do të mbajë një bazë të dhënash për të gjitha pajisjet e reagimit kombëtar ndaj ndotjeve detare nga nafta, duke përfshirë dhe rezervat e shpërndarësve kimik. Të gjitha pajisjet për reagim, do të mbahen në zbatim të standardeve të specifikuara në planet e mirëmbajtjes të bëra nga QNOD-ja për garantimin e gatishmërisë, disponueshmërisë dhe sigurisë.

10.8 Inventari i pajisjeve dhe i artikujve për reagimin ndaj të gjitha rrjedhjeve në dispozicion të Republikës së Shqipërisë për përdorim gjatë operacioneve të reagimit ndaj ndotjeve detare, në pronësi të enteve publike dhe private është dhënë në aneksin 21. Inventari përfshin emrat dhe detajet e kontakteve të këtyre entiteteve dhe të personave përgjegjës, gjithashtu, dhe të vendndodhjes së saktë të rezervave.

10.9 Për të gjithë artikujt e pajisjeve në pronësi të QNOD-së që përdoren gjatë operacioneve të reagimit në shkallën 1, 2 dhe 3, QNOD-ja duhet të përcaktojë normat e qirasë ose vlerat e zëvendësimit, kur ato konsumohen. Shpenzimet e zëvendësimit të artikujve të dëmtuar ose shkatërruar, do të paguhën nga ndotësi, ose siguruesi i tij, ose do të kompensohen nëpërmjet regjimit ndërkombëtar të kompensimit, sipas nevojës.

10.10 Koordinator i Përgjithshëm Kombëtar mundëson angazhimin e ndërmarrjeve të specializuara që kanë të bëjnë me ndotjen detare, sipas nevojës dhe përkatësisë.

#### Personeli

10.11 Kërkesat për personelin që merr pjesë gjatë operacioneve të reagimit ndaj një incidenti me ndotje detare, do të vendosen sipas rastit në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të incidentit. Në rastin e reagimit të shkallës 3 këto kërkesa përcaktohen nga Koordinator i Përgjithshëm Kombëtar, në konsultë me skuadrën e menaxhimit të operacionit dhe Koordinatorit Kombëtar në Terren, dhe në rastin e reagimit të shkallës 2 nga oficeri në drejtim i Forcës Detare (për operacionet në det) dhe Prefekti i Qarkut përkatës (për operacionet në breg).

10.12 Personeli përgjegjës për reagimin ndaj rrjedhjes, të trajnuar ose jo për reagimin fillestar ndaj incidenteve me ndotje detare, do të rekrutohen nga institucionet, departamentet, shërbimet kombëtare dhe agjencitë e përcaktuara në Planet lokale, zonale(rajonale) dhe kombëtare. Në nivelin kombëtar, ky personel do të vihet në dispozicion për një reagim madhor në zonën e tyre ose në ndonjë zone tjetër. Lista e burimeve, personelit përgjegjës për rrjedhjet, duke përfshirë detajet e kontaktit dhe emrat e personave përgjegjës, është dhënë në aneksin 22.

10.13 Në rastet e operacioneve të reagimit madhore dhe të përzgjatura, Koordinator i Përgjithshëm Kombëtar mund të vendosë të rekrutojë forca punëtore rezerve, nga shërbimet publike dhe kompanitë private.

#### Kontratat dhe memorandumet e mirëkuptimit

10.14 Me qëllim për të garantuar disponueshmerine e ekspertëve, personave të trajnuar dhe fuqisë punëtore, QNOD-ja si autoriteti qeveritar përgjegjës për reagimin ndaj ndotjes detare, do të lidhë marrëveshje paraprake me agjencitë publike ose kompanitë e sektorit privat, dhe kushtet për përfshirjen e punonjësve të tyre në raste emergjence. QNOD-ja do të përfundojë me çdo entitet publik ose privat, një memorandum mirëkuptimi (MoU), kontrate tregtare ose marrëveshje, sipas nevojës, duke përcaktuar rolet e tyre, përgjegjësitë dhe kushtet për angazhimin e personelit të tyre ose burimeve të tjera.



#### Asistenca ndërkombëtare

10.15 Kur zgjatja e parashikuar e operacioneve të reagimit, bazuar në vlerësimin e bërë nga Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar, i tejkalon mundësitë e reagimit të Republikës së Shqipërisë, Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar kërkon, nëpërmjet kanaleve përkatëse, asistencë nga shtete të tjera, në mënyrë direkt apo nëpërmjet REMPEC, duke zbatuar parimet e protokollit për parandalimin dhe emergjencën 2002, ose në zbatim me OPRC 90 ose çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare në të cilën Republika e Shqipërisë është palë. (Shiko, gjithashtu, seksionin 13 të planit.)

10.16 Procedurat për kërkimin dhe paraqitjen e asistencës ndërkombëtare janë të përshkruara në aneksin 23.

#### 11. TRAJNIMET DHE STËRVITJET

11.1 Të gjithë personat e përcaktuar për të marrë pjesë në zbatimin e planeve të emergjencës të shkallës 1, shkallës 2 dhe shkallës 3, duhet të jenë të trajnuar dhe kualifikuar për detyrat e tyre të parashikuara. Trajnimi, kryhet nëpërmjet kurseve, ushtrimeve të trajnimit dhe stërvitjeve në nivelet lokale, rajonale dhe kombëtare.

11.2 QNOD-ja në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet mjedisore, ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë, ministrinë përgjegjëse për çështjet detare dhe ministrinë përgjegjëse për emergjencat civile është përgjegjës për organizimin e trajnimeve dhe ushtrimeve në nivel kombëtar, si dhe për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në trajnime dhe ushtrime të organizuara në nivel ndërkombëtar. Në çdo rast, ministritë e përmendura më sipër, do të informohen për programin e trajnimeve

11.3 Oficerët drejtues të Forcës Detare, në bashkëpunim me agjencitë rajonale të mjedisit dhe prefektin e qarkut janë përgjegjës për organizimin e trajnimeve dhe ushtrimeve në nivelin rajonal.

11.4 Entet publike dhe private të listuara në aneksin 6, janë përgjegjëse për organizimin e trajnimeve dhe ushtrimeve në nivel lokal.

11.5 Koordinatori i Përgjithshëm Kombëtar mund të vendosë të kombinojë trajnimin dhe ushtrimet në nivele të ndryshme, dhe të ftojë personelin e zonës (rajonal) dhe specialiste të veçantë, të marrin pjesë në mënyrë periodike në trajnimin për reagimin në shkallën 3, përveç ushtrimeve të programuara.

11.6 Objektivat e trajnimit dhe ushtrimeve janë:

- për përmirësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet reaguesve;
- testimin e hallkave të drejtimit të planeve të emergjencës;
- testimin e komunikimit në të gjitha nivelet e reagimit;
- testimin e pajisjeve dhe përmirësimin e aftësive të personelit që merr pjesë në operacionet e reagimit për përdorimin e pajisjeve, artikujve dhe mjetet e tjera të operacionit të reagimit;
- fitimin e eksperiencës;
- trajnimin e anëtarëve të skuadrës së menaxhimit të incidentit, Komitetit Teknik dhe grupeve të reagimit, në procesin e vendimmarrjes, drejtimit dhe menaxhimit të operacioneve të reagimit, gjithashtu, edhe në çështje të tjera të lidhura me ndotjen detare;
- analizimin e veprimeve të kryera gjatë zbatimit të planit dhe planeve rajonale të emergjencës kryesisht mbi veprimet e enteve të veçanta.

11.7 Ushtrimet do të përfshijnë:

Ushtrimet e lajmërimit me qëllim testimin e sistemit të komunikimit;

Ushtrime tavoline me qëllim testimin strukturën menaxhuese të operacioneve të reagimit ndaj ndotjeve detare;

Ushtrime për shpërndarjen e pajisjeve, kombinuar me ushtrime për menaxhimin e incidentit, për testimin e përgatitjes në kryerjen e operacioneve të pastrimit në det dhe në breg;

11.8 Ushtrimet e lajmërimit organizohen çdo vit nga QNOD-ja në nivelet kombëtare dhe rajonale.

11.9 Ushtrimet e tavolinës organizohen çdo dy vjet nga QNOD-ja në nivel kombëtar dhe në bashkëpunim me ARM-të, pushteti lokal dhe nga Forca Detare në nivelin rajonal çdo dy vjet.

11.10 Ushtrimet për shpërndarjen e pajisjeve organizohen nga QNOD-ja në nivelin kombëtar dhe në bashkëpunim midis dhe Rojës Bregdetare në nivelin përkatës rajonal, çdo dy vjet dhe e alternuar me ushtrimet e tavolinës.

11.11 Shpërndarja e kombinuar e pajisjeve dhe ushtrimet për menaxhimin e incidentit në nivel kombëtar, organizohen çdo tre vjet nga QNOD-ja. Në vitin kur do të organizohet ushtrimi i kombinuar kombëtar, ushtrimi i shpërndarjes kombëtare dhe rajonale të pajisjeve nuk do të kryhet.

11.12 Çdonjëra nga këto ushtrime, do analizohet dhe përdoret për përditësimin dhe përmirësimin sipas nevojës të planeve përkatëse të emergjencës, duke përfshirë dhe anekset.

11.13 Kurset e trajnimit në nivel kombëtar organizohen nga QNOD-ja të paktën një herë në dy vjet. Këto kurse duhet të ndjekin nivelin 2 të modelit të kurseve trajnuese të IMO OPRC.

11.14 Kurset e trajnimit në nivel rajonal organizohen përkatësisht nga ARM-të, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile dhe Forca Detare çdo dy vjet, duke u alternuar me kurset kombëtare. Kurset rajonale duhet të ndjekin nivelin 1 të modelit të kurseve trajnuese IMO OPRC.

11.15 Nëse do jetë e nevojshme, Koordinatori i Përgjithshëm mund të vendosë të organizojë kurse në nivel kombëtar apo rajonal më shpesh sesa ai i parashikuar dhe t'i ndryshojë programet e tyre në përputhje me kërkesat.

11.16 QNOD-ja është përgjegjëse për përgatitjen e programeve dyvjeçare të trajnimeve dhe ushtrimeve në nivel kombëtar dhe rajonal, dhe të verifikojë trajnimet për shkallën 1 të përgatitura nga operatorët dhe drejtuesit e porteve/autoriteteve portuale dhe pajisjeve apo instalimeve detale dhe ato në breg.

11.17 Përfaqësuesit e instalimeve detare dhe bregdetare përgjegjës për reagimin në shkallën 1 do të ftohen të marrin pjesë në aktivitetet trajnuese kombëtare dhe rajonale, sipas nevojës.

## 12 VENDET E STREHIMIT

12.1 Në rrethana të veçanta, drejtimi i një anijeje të dëmtuar për në një vendstrehim, mund të jetë një veprim me përparësi për parandalimin ose zvogëlimin e efekteve të dëmshme të një derdhjeje. QNOD-ja në konsulencë me Drejtorinë e Përgjithshme Detare mund të përcaktojë ndonjë zonë të përshtatshme si vendstrehim, në pajtim me rezolutën A 949(23) të Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) në lidhje me “Udhëzimet mbi vendstrehimin për anijet në nevojë për asistencë”, në varësi të një varg faktorësh mjedisore dhe klimaterike, si dhe të natyrës së incidentit.

12.2 Pasi autoriteti kombëtar kompetent i Republikës së Shqipërisë (Drejtoria e Përgjithshme Detare) të ketë zhvilluar kriteret për vlerësimin e përshtatshmërisë të vendeve të strehimit, në pajtim me udhëzimet e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) dhe praktikës më të mire ndërkombëtare, kjo do t'i bashkëngjitet planit në aneksin 24.

12.3 Pasi një anije të ketë kërkuar një vend për strehim, ose autoriteti kombëtar kompetent (Drejtoria e Përgjithshme Detare) të ketë marrë vendimin nga për të lëvizur anijen në një vendstrehim, të gjitha alternativat do të gjykohen sipas kriterëve të përcaktuar për zgjedhjen e vendstrehimit më të përshtatshëm në varësi të rrethanave mbizotëruese.

## 13. MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE PËR REAGIMIN NDAJ NDOTJEVE

13.1 Në rastin e ndodhjes së një incidenti me ndotje madhore të mjedisit në çfarëdo vendit në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë që i kalon kapacitetet reaguese brenda shtetit, autoriteti kombëtar kompetent (QNOD) mund të kërkojë asistencë ndërkombëtare për operacionet e reagimit në shkallën 3.

13.2 Gjithashtu, Republikës së Shqipërisë mund t'i kërkohet për të dhënë asistencën e saj ndaj një shtetit tjetër që është prekur nga incidente të njëjta, dhe ka detyrimin e përbashkët për të përmbushur detyrimet nën konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe rajonale të cilat është



anëtare, dhe për të dhënë palëve të tjera anëtare të këtyre konventave dhe marrëveshjeve asistencë edhe jashtë ujërave territoriale shqiptare.

13.3 Konventa ndërkombëtare “Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi (OPCR) 1990 në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9692, datë 8.3.2007 dhe Konventa “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të detit Mesdhe” së bashku me protokollet në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 8690, datë 16.11.2000 mundësojnë bazat për asistencë ndërkombëtare dhe për të nënshkruar marrëveshjet përkatëse rajonale dhe nën-rajonale.

13.4 Ky angazhim reciprok mund edhe të reflektohet në çfarëdo marrëveshje dhe Memorandum Mirëkuptimi për ndihme të përbashkët, që do konsiderohet i përshtatshëm.

13.5 Asistencë do t’i mundësohet edhe kombeve të tjera në pajtim me këto marrëveshje formale, dhe vetëm nëse ekzistojnë marrëveshje të tilla të mëparshme mund të ndërmerren nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme. QNOD-ja do të marrë në konsideratë kërkesat për asistencë jashtë Republikës së Shqipërisë rast pas rastit, duke pasur parasysh kërkesat për të mbajtur kapacitetin reagues Shqiptar.

#### 14. KOMPENSIMI DHE SHPENZIMET

14.1 Kur është e mundur, të gjitha shpenzimet e arsyeshme të çdo operacioni reagimi ndaj ndotjes dhe operacioni pastrimi do të paguhet nga ndotësi. Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të garantuar rimbursimin e shpenzimeve të kryera gjatë operacioneve të reagimit ndaj ndotjes.

14.2 Duke qenë anëtar i protokollit të Konventës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësisë Civile për Dëmtimin nga Ndotja me Karburant 1992 (CLC 92) dhe protokollit të Konventës Ndërkombëtare mbi Krijimin e një Fondi Ndërkombëtar për Kompensimin e Dëmtimit nga ndotja me Karburant 1992 (FUND 1992), Shqipëria, kur është e aplikueshme, do të kërkojë kompensimin për dëmtimin nga ndotja e shkaktuar nga karburanti i qëndrueshëm nën këto dy regjimeve të kompensimit ndërkombëtar.

14.3 Ministria përgjegjëse për çështje detare do të sigurojë emrat e importuesve, të cilët importojnë në Shqipëri më shumë se 150 000 tonë naftë bruto dhe lëndë djegëse e rëndë në një vit kalendarik, dhe të raportojë në baza vjetore te Fondi Ndërkombëtar për Kompensimin e Ndotjes nga Nafta (IOPC Fund 1992) në pajtim me kërkesat e kësaj të fundit. Një kopje e formatit raportues është i bashkëngjitur në aneksin 25.

14.4 Në lidhje me shpenzimet e operacioneve të arsyeshme të pastrimit në det dhe në breg, si dhe masat e tjera të ndërmarra për të parandaluar apo zvogëluar dëmtimin nga ndotja, shpenzimet e rikuperueshme përfshijnë:

- shpenzimet e masave mbrojtëse të ndërmarra për qëllim parandalimin ose zvogëlimin e ndotjes dhe çdo humbje ose dëmtimi tjetër të shkaktuar nga këto masa;
- shpenzimet e monitorimit, marrjes së mostrave dhe analizave të tyre;
- shpenzimet e analizës së situatës;
- kompensimin e shpenzimeve që mund të kryhen në lidhje me efektin direkt (drejtpërdrejtë) apo indirekt (humbje e pastër ekonomike) e ndotjes mbi burimet natyrore dhe ekonomike;
- kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme të pastrimit, riparimit ose zëvendësimit të pasurisë që kontaminohet nga ndotja;
- kompensimin për masat e arsyeshme të rivendosjes të ndërmarra ose që do të ndërmerren për të shpejtuar pastrimin e dëmtimit mjedisor;
- kontribute mund të jepen edhe për shpenzimet e studimeve pas ndotjes, duke përfshirë studimin për të vendosur natyrën dhe shtrirjen e dëmtimit mjedisor të shkaktuar nga derdhja e naftës dhe për të përcaktuar nëse janë të nevojshme dhe të parashikueshme masat për rikthimin në pozitën e mëparshme.

14.5 Pretendimet për kompensimin e dëmeve nga ndotja, do të përgatiten në zbatim me udhëzimet e paraqitura në manualin e pretendimeve të publikuar, periodikisht nga fondi IOPC, i cili përcakton ç'fare lloj pretendimesh konsiderohen si të pranueshme dhe si ta bësh një kërkesë. Një kopje e manualit të pretendimeve të fondit IOPC i është bashkëngjitur këtij plani si aneksi 26.

14.6 Në të gjitha rastet, grupi i administrimit do të mbajë të dhëna të plota dhe të sakta mbi incidentin, si dhe një llogari të plotë të gjitha shpenzimeve të operacioneve të reagimit ndaj ndotjes siç përcaktohet në paragrafin 5.30 të këtij plani.

#### 15. MEDIA

15.1 Një incident detar, është me një interes të drejtpërdrejtë të medias lokale dhe në varësi të shkallës dhe natyrës së incidentit, mund të rezultojë në vëmendjen e medias kombëtare dhe asaj ndërkombëtare. Është në interes të publikut dhe në interes të gjithë personave të përfshirë, ta mbajnë median e informuar sa më shumë e sa më rregullisht të jetë e mundur. Dështimi për të marrë në konsideratë reagimin e medias në një fazë të hershme, mund të ketë implikime serioze në menaxhimin e të gjithë incidentit.

Personi i caktuar për marrëdhëniet me median

15.2 Që në fillim, pas ndodhjes së incidentit, QNOD-ja do të përcaktojë një person, i cili do të koordinojë me median. Roli kryesor i të cilit është të mbaje lidhje me shtypin për llogari të QNOD-së. Kryesisht, detyra e zëdhënësit është të këshillojë Koordinatorin e Përgjithshëm Kombëtar mbi marrëdhëniet me median, të ndërmarrë konferenca shtypi dhe të japë buletine të rregullta lajmesh.

15.3 Zëdhënësi, do të garantojë që media të mos ndërhyjë në aktivitetin operacional të shërbimeve të emergjencës.

#### 16. FINANCIMI

16.1 Financimi i përgatitjes dhe kryerjes së aktiviteteve të reagimit në zbatim të planit të emergjencës do të planifikohet brenda buxhetit të miratuar për ministrinë, institucionet buxhetore, shërbimet kombëtare që marrin pjesë në QNOD, si edhe i pushtetit lokal që merr pjesë në këto operacione.

Fondet e marra nga ndotësi, agjencia e sigurimit në rast se ndotësi është i identifikuar, si edhe mekanizmat ndërkombëtar të kompensimit si kompensim për shpenzimet e ndotjes të bëra nga shteti, do të kthehen menjëherë në buxhetin e shtetit.

16.2 Ministrinë dhe institucionet e linjës brenda buxhetit të tyre të miratuar duhet të planifikojnë financimin e veprimtarive si më poshtë:

- blerja, ndërtimi dhe shërbimi i pajisjeve të specializuara për reagimin ndaj ndotjes;
- shpenzimet për një pjesë të mirëmbajtjes të pajisjeve të specializuara për reagimin ndaj ndotjes të menaxhuara nga palët e treta;
- shpenzimet në lidhje me veprimet administrative dhe sigurimin e mbështetjes logjistike të skuadrës së menaxhimit të incidentit;
- shpenzimet në lidhje me trajnimin dhe ushtrimet në nivel zone (rajoni), kombëtar dhe ndërkombëtar;
- përgatitja e projekteve të rehabilitimit dhe aktiviteteve reaguese në rast të ndotjes detare aksidentale të shkaktuar nga anijet e mbytura në posedim të Shqipërisë;
- shpenzimet në lidhje me ndërmarrjen e masave reaguese, kur ndotësi nuk është identifikuar ose nuk është në gjendje të mbulojë shpenzimet e reagimit;
- shpenzimet e vlerësimit të rrezikut dhe përgatitjen e hartave të ndjeshmërisë;
- shpenzimet për përgatitjen e mjeteve mbështetëse të vendimit (aplikimet e programit) për zbatimin e planit.

16.3 Shpenzimet që kanë të bëjnë me eliminimin e një kërcënimi për ndotje detare, kur ndotësi është i identifikuar, shpenzimet për masat e menjëhershme për reagimin ndaj ndotjes detare, do të paguhet nga buxhetet e ministrive respektive para dorëzimit të pretendimit për kompensimin e





shpenzimeve nga ndotësi, siguruksi i tij ose ndonjë burim tjetër, siç janë fondi IOPC. QNOD-ja nëpërmjet institucioneve pjesëmarrëse do të sigurojnë burimet për aktivitetet e personave ligjore dhe privat, që kryejnë operacione të menjëhershme reagimi dhe parandalimi ndaj ndotjes (rimorkimin, luftën kundër zjarrit, shpërndarjen e shiritave kufizues, përdorimin e tankerëve, përdorimin e pajisjeve të tjera dhe shpenzime të tjera përkatëse) dhe përgatitin vlerësimin e shpenzimeve për dhënien me qira ose në përdorim të anijeve ose pajisjeve. Këto vlerësime të shpenzimeve do të mbahen te QNOD-ja.

#### 17. DISPOZITAT KALIMTARE DHE KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Përgatitja dhe rishikimi i planeve të emergjencave të shkallës 1

17.1 Autoritetet lokale të përmendura në paragrafin 2.22 duhet të përgatisin (vete ose qiramarrësit) plane lokale emergjence specifike të shkallës 1 dhe të mbajnë kapacitete reagimi të mjaftueshme për reagimin fillestar ndaj ndotjeve detare në zonën e tyre të përgjegjësisë.

17.2 Të gjitha plane lokale të emergjencës të shkallës 1 duhet të jenë në pajtueshmëri me planet rajonale të emergjencës, si dhe planin aktual. Të gjitha planet lokale të emergjencës të shkallës 1 duhet të miratohen nga QNOD-ja në konsultim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe ARM-të përkatëse.

17.3 Entet që kërkohet të kenë plane të shkallës 1 në përputhje me paragrafin 2.22, siç parashikohen në aneksin 6 janë të detyruar të paraqesin planet e tyre përkatëse për miratim te QNOD-ja jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me miratimin e planit.

17.4 Kontrolluesit e incidentit, janë përgjegjës për rishikimin e planeve lokale përkatëse (planeve të shkallës 1) dhe për t'i mbajtur ato të përditësuara.

Përgatitja dhe rishikimi i planeve të emergjencës të shkallës 2

17.5 Autoritetet rajonale përgjegjëse të përmendura në paragrafin 2.12 do të përgatisin planet përkatëse rajonale të emergjencës të shkallës 2 dhe do të mbajnë kapacitete të mjaftueshme reagimi për reagimin fillestar ndaj incidenteve me ndotje në zonat e tyre të përgjegjësisë.

17.6 Planet rajonale të emergjencës do të jenë në përputhje të plotë me planin kombëtar të emergjencës dhe të miratuara nga QNOD-ja.

17.7 Autoritetet rajonale përgjegjëse kërkohet të kenë plane të shkallës 2, janë të detyruar të paraqesin planin e tyre përkatës për miratim te QNOD-ja jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me miratimin e këtij plani.

17.8 Drejtuesit e Forcës Detare, në bashkëpunim me prefektin e qarkut përkatës, janë përgjegjës për rishikimin e planeve rajonale për shkallën 2 dhe t'i mbajnë ato të përditësuara.

17.9 QNOD-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen, përditësimin dhe zbatimin e planit kombëtar të emergjencës. Kjo përfshin mirëmbajtjen e një plani të përgjithshëm që përmban procedurat operative.

17.10 QNOD-ja duhet të sigurojë që vlerësimi i rrezikut dhe vlerësimi i ndjeshmërisë/përgatitjes së hartave të ndjeshmërisë, të jetë përfunduar jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me miratimin e planit.

17.11 QNOD-ja duhet të përgatisë politikat kombëtare për përdorimin e shpërndarësve kimik jo më vonë se 12 muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me miratimin e planit.

17.12 Jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me adoptimin e planit, ministria përgjegjëse për hidrokarburet dhe ministria përgjegjëse për mjedisin do të përgatisin një plan kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të naftës dhe do të përcaktojnë vende të përkohshme për hedhjen e mbetjeve të naftës në vende të ndryshme përgjatë bregut.

17.13 Është përgjegjësia e QNOD-së për kompletimin e gjitha anekseve të këtij plani jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me miratimin e planit.

16.14 Ky plan dhe anekset e tij do të përditësohen rregullisht nga skuadra e menaxhimit të incidentit, nën mbikëqyrjen e plotë të Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar.

17.15 Ky plan do të rishikohet, nëse do jetë e nevojshme nga skuadra e menaxhimit të incidentit, në konsultë me të gjitha administratat, organizatat, shërbimet dhe institucionet kombëtare përkatëse, pas çdo incidenti me ndotje detare apo ushtrimi.

Shpërndarja

17.17 Lista e shpërndarjes së këtij plani dhe çdo përditësim është paraqitur në aneksin 27.

## ANEKSET 2012

### ANEKSI 1.

#### LISTA E TRAKTATEVE DHE MARRVESHJEVE NDËRKOMBËTARE MBI ASISTENCEN E NDËRSJELLTË NË TË CILËN REPUBLIKA E SHQIPËRISË ËSHTË SHTET ANËTAR

##### Konventat Ndërkombëtare:

- *Konventa Ndërkombëtare mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Karburantet 1990 (OPRC 1990) aderuar me Ligjin Nr. 9692 datë 08.03.2007;*
- *Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjeve nga Anijet 1973 ndryshuar me Protokollin e vitit 1978 (MARPOL '73-'78) aderuar me Ligjin Nr. 9594 datë 27.07.2006.*

##### Konventat Rajonale:

- *Konventa për "Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe të Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe, si dhe të Protokolleve Shoqëruese (Konventa e Barcelonës)1976" aderuar me Ligjin Nr. 8690 datë 16.11.2000;*

##### Konventa Ndërkombëtare të tjera

- *Konventa Ndërkombëtare për Shpëtimin, 1989 (SALVAGE 1989) aderuar me Ligjin Nr. 9495 datë 20.03.2006;*
- *Konventa Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmet nga Ndotja me Karburant (CLC 1992) aderuar me Ligjin Nr. 9293 datë 21.10.2004;*
- *Konventa Ndërkombëtare mbi Themelimin e një Fondi Ndërkombëtar për Kompensimin për Dëmtimet nga Ndotja me Karburant (FUND 1992) aderuar me Ligjin Nr. 9292 datë 21.10.2004;*
- *Konventa Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmtimet nga Ndotja me Karburant nga Anijet-Cisterne, 2001 (BUNKERS 2001) aderuar me Ligjin Nr. 10224 datë 04.02.2010;*
- *Konventa Ndërkombëtare për Kufizimin e Përgjegjësive për Reklamimet Detare 1976 së bashku me protokollet shoqëruese (LLMC 1976) aderuar me Ligjin Nr. 9212 datë 25.03.2004;*
- *Konventa Ndërkombëtare për Përgjegjësitë Civile dhe Dëmshpërblimin për Dëmet në lidhje me Transportin e Lëndëve të rrezikshme dhe Helmuese (HNS 1996) aderuar me Ligjin Nr. 10290 datë 24.06.2010.*



## ANEKSI 2


### LISTA E LEGJISLACIONIT KOMBËTAR PËRKATËS

- Ligji Nr. 7746 datë 28.07.1993 "Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi) i ndryshuar.
- Ligji Nr. 7895 datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar
- Ligji Nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre";
- Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001, mbi "Emergjencat Civile" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8766 datë 05.04.2001 "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8875 datë 04.04.2002, "Për Rojën Bregdetare Shqiptare" i ndryshuar;
- Ligj Nr. 8905, datë 06.06.2002, mbi "Për mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Mbrojtja dhe Dëmtimi" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9130 datë 24.01.2008 për "Autoritetin Portual";
- Ligji Nr. 9251, datë 08.07.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9281 datë 23.09.2004 "Për Sigurinë në Anije dhe Porte";
- Ligji Nr. 9861, datë 24.01.2008, "Për Kontrollin dhe Mbikqyrjen e Kufirit Shtetëror";
- Ligji Nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit";
- Ligj Nr. 10435, datë 23.06.2011 "Për Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë";
- Vendim i Këshilli të Ministrave Nr. 1214 datë 03.09.2008 "Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit"
- Vendim i Këshilli të Ministrave Nr. 772 datë 24.09.2010 "Për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 954, date 30.09.2009, "Për Organizimin, Strukturën, Funksonimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe Bashkëveprimin me Institucionet Shtetërore, që kanë interesa në det" i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 439, date 13.05.2011, "Për miratimin e politikave dhe procedurat e funksionimit të QNOD";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 596 datë 09.10.2004, Për "Miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij" i ndryshuar;

### ANEKSI 3.

## ZONAT GJEOGRAFIKE QË MBULON PLANI KOMBETAR I EMERGJENCËS

(të plotësohet nga QNOD jo më vonë se 6(gjashtë) muaj nga publikimi i  
Vendimit të Këshillit të Ministrave në Fletoren Zyrtare)





## ANEKSI 4.

### ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

#### **E ADMINISTRATAVE KRYESORE KOMBËTARE, ORGANIZATAVE, SHERBIMEVE DHE INSTITUCIONEVE TË PARASHIKUAR PËR TË MARRË PJESË NË ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË EMERGJENCËS**

##### Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)

QNOD është një strukturë koordinuese Ndërinstitucionale me detyrën për organizimin, planëzimin dhe menaxhimin e operacioneve detare në detin territorial. Qendra koordinon Operacionet e Kërkim Shpëtimit, parandalon dhe mbron mjedisin detar nga ndotja, dhe koordinon punën me ministrinë përkatëse për mjedisin operacionet për parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja (VKM Nr. 954 datë 30.09.2009 i ndryshuar)

Një nga detyrat kryesore të QNOD është koordinimi dhe organizimi efektiv i operacioneve për mbrojtjen nga ndotja detare (VKM Nr. 439 datë 13.05.2011).

Detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme të QNOD janë:

- Përgjegjësinë e kryesore për përgatitjen dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Emergjencës (PKE)
- Zbatimin dhe mbikëqyrjen e gjithë aktiviteteve në lidhje me përgatitjen dhe reagimin ndaj ndotjes detare të shkakuar nga karburanti ose Lëndët e Dëmshme e të Rrezikshme në rast emergjence;

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të QNOD janë:

- Sigurimin e një platforme bashkëpunimi midis institucioneve që kanë interes në det;
- Koordinimin e oracioneve kërkim-shpëtimi në lidhje me incidentet me ndotje detare;
- Integrimin e përdorimit të burimeve kombëtare;
- Garantimin e ndërlidhjes, bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve me institucionet dhe shërbimet pjesëmarrëse:
  - Ministrinë e Brendshme (Policia Kufitare);
  - Ministrinë e Mbrojtjes (Forca Detare);
  - Ministrinë e Financës (Dogana);
  - Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve e Administrimit të Ujerave (Inspektimet e Peshkimit);
  - Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit;
  - Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
  - Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

- Garantimin e një bashkërendimi institucional efektiv;
- Mbledhja e informacioneve;
- Garantimin e shkëmbimit të informacionit;
- Monitorimin e zonave të ndotura nga incidenti nëpërmjet Sistemit të Integruar të Mbikëqyrjes Detare dhe pajisjen e menaxhimit të incidentit me informacionin përkatës;
- Përqendrimin e komunikimeve në lidhje me incidentet me ndotje;
- Veprimin si Qendër Operimi për Koordinatorin Kombëtar të Përgjithshëm, Koordinatorin në terren dhe Skuadrën për Menaxhimin e Incidentit
- Mbajtur, përditësuar dhe zbatuar Planin Kombëtar të Emergjencave;
- Kompletuar dhe përditësuar Aneksit e PKK;
- Te garantojnë përgatitjen në kohë të vlerësimit të rrezikut dhe hartave të ndjeshmërisë;
- Zhvillimin e politikave kombëtare mbi përdorimin e detergjenteve;
- Kryerjen e një Rrjeti Analizash Përfitimë Mjedisore (RAPM) me qëllimin për të përcaktuar zonat ku përdorimi i detergjenteve është i para autorizuar ose ndaluar rreptësisht;
- Garantimin e shpërndarjes së shpejtë të gjithë amendamenteve dhe përditësimet e Planit dhe Aneksëve të tij;
- Përcaktimin e Koordinatorit të Përgjithshëm kombëtar;
- Emërimin e Specialistit të Zgjedhur për Shtypin (SZS);
- Përcaktimin e vendeve për strehim;
- Mbikëqyrjen dhe auditimin e përgatitjes, zbatimit dhe implementimit të planeve të emergjencës lokale dhe zonale;
- Miratimin e Planeve të Emergjencës Rajonale;
- Miratimin e Planeve të Emergjencës Lokale;
- Mbikëqyrjen e përgatitjes dhe reagimit në lidhje me aktivitetet e porteve, limaneve, терминаlet e karburantit, mjete të tjera bregdetare dhe platformat detare;
- Sigurimin me numra telefoni për kontakt 24 ore në ditë për raportimin e incidenteve me ndotje detare;
- Të mundësojë të gjitha entiteteve kombëtare me një format për njoftimin të brendshëm;
- Të sigurojë disponibilitetin brenda vendit të një sasive të mjaftueshme të pajisjeve për reagimin si edhe mjete të tjera për reagimin në Shkallen 3.
- Sigurojë që Forca Detare të pajiset me pajisje të mjaftueshme për reagimin në Shkallen 2;
- Planifikoje blerjen e pajisjeve të reja dhe zëvendësimin e atyre të dëmtuara (duke u konsultuar me Skuadrën e menaxhimit të Incidentit, dhe Rojën Bregdetare);
- Mbajtur e një sistemi të dhënash për gjithë mjetet kombëtare që do të përdoren për reagimin ndaj një derdhe karburanti duke përfshirë dhe rezervat e detergjenteve;
- Zhvillimin e planeve të mirëmbajtjes për gjithë pajisjet e reagimit në pronësi të Shtetit;
- Të Sigurojë mirëmbajtjen e nevojshme për gjithë pajisjet e reagimit në pronësi të Shtetit;
- Vendosijen e normave të vlerës së qirasë për pajisjet e reagimit në pronësi të Shtetit;
- Të marrë masat dhe të firmose marrëveshje me agjencitë publike ose kompani të sektorit privat në lidhje me kushtet e marrjes pjese të personelit të tyre ose burimeve të tjera në aktivitetet e reagimit ndaj ndotjes detare;



- Organizojë trajnime dhe ushtrime ne nivel kombëtar, dhe vendose ne pjesëmarrjen e Shqipërisë ne trajnime dhe ushtrime te organizuara ne nivel ndërkombëtar;
- Të mbikëqyre reagimin ne incidentet e Shkalles 2.
- Menaxhimin e reagimit te incidenteve ne Shkallen 3 ne përputhje me Planin;
- Kërkojë asistencë ndërkombëtare për reagimin ne Shkallen 3;
- Të marre parasysh kërkesat për asistencë adresuar ndaj autoriteteve Shqiptare;
- Të mbajë rekorde për te gjitha incidentet e vërejtura me ndotje detare;
- Të mbajë rekorde për te gjitha veprimet e ndërmarra gjate reagimit ndaj incidenteve me ndotje detare;
- Të raportoje Këshill të Ministrave dhe ministrive përkatëse, agjencive kombëtare dhe organizatave ndërkombëtare;
- Të sigurojë që marrësit (importuesit) e naftës bruto dhe karburanteve te renda te raportojnë çdo vit tek DPD ne përputhje me kërkesat e FUND 1992;
- Përgatisë dhe prezantoje Këshillit të Ministrave buxhetin vjetor mbi aktivitetet ne lidhje me përgatitjen dhe reagimin ndaj ndotjeve detare;

#### Ministria përgjegjëse për mjedisin

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka përgjegjësinë direkte për mbrojtjen e mjedisit detar.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Bashkëpunimin me institucionet e tjera nëpërmjet QNOD për operacionet për parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja;
- Monitorimin nëpërmjet Agjencive Rajonale të Mjedisit performancën e porteve, autoriteteve portuale, pajisjeve dhe instalimeve detare dhe ato në breg të detyrës në lidhje me parapërgatitjen dhe reagimin ndaj ndotjeve të Shkallës 1. Organizimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve në lidhje me parapërgatitjen dhe reagimin në Shkallën 2, dhe në rast të incidenti me ndotje detare drejtimin dhe mbikëqyrjen e operacioneve të Shkallës 2 në bregdet.

Rolet dhe përgjegjësitë specifike:

- Bashkëpunimin me QNOD mbi të gjitha çështjeve në lidhje me përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve që shkaktojnë apo mund të shkaktojnë ndotje detare.
- Ndihmojë QNOD në përcaktimin e metodave dhe qëllimeve për operacionet e pastrimit bregdetar.
- Organizimin dhe kontrollin e operacioneve te vijës bregdetare (nëpërmjet zyrave te saj rajonale) ne bashkëpunim me Mbrojtjen Civile dhe Bashkitë, dhe me ndihmën e institucioneve te tjera ne lidhje me reagimin e Shkalles 2 dhe Shkalles 3;
- Drejtimin e përgjithshëm të operacioneve të pastrimit të vijës bregdetare në rast të reagimeve të Shkalles 2 dhe Shkalles 3, nën drejtimin e përgjithshëm të QNOD dhe/ose Koordinatorit të Përgjithshëm Kombëtar.
- Identifikimin e vendeve potenciale te përkohshme për hedhjen e mbetjeve te karburantit ne lokalitete te ndryshme përgjatë bregut;
- Identifikimin, Në bashkëpunim me METE, të pajisjeve që mund të para-përpunojnë dhe përpunojnë mbetjet e karburantit dhe vendosjen e marrëdhënieve me pajisjet përkatëse për përdorimin e shërbimit te tyre ne rastet e ndotjes detare;

- Zhvillimin dhe/ose mirëmbajtjen, në bashkëpunim me METE, të Planit për Menaxhimin e Mbetjeve të Karburanteve të Dërdhura (PMMKD);
- Organizimin dhe menaxhimin, në bashkëpunim me METE të operacioneve të hedhjes së mbeturinave, në përputhje me rregulloret përkatëse;

#### Forca Detare

- Përgatitjen, mirëmbajtjen dhe zbatimin e Planeve Rajonalë të Emergjencës në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Mjedisit.
- Mbajtjen e kapaciteteve reaguese për reagimin fillestar në incidentet e Shkallës 2.
- Lajmërimin e QNOD mbi çdo ndotje detare të konstatuar apo raportuar.
- Reagimin në bashkëpunim me ARM, gjatë incidentet e Shkallës 2 në përputhje me planet përkatëse;
- Reagimin në incidentet e Shkallës 3 në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave.
- Kërkesën për përshkallëzimin e reagimit nga Shkalla 2 në Shkallën 3;
- Aktivitetet të tjera në lidhje me përgatitjen për reagimin ndaj ndotjes detare nga nafta dhe substancave të rrezikshme dhe helmuese;
- Organizimin e trajnimeve dhe ushtrimeve në përputhje me kërkesat e Planit.

#### Autoritetet Rajonale

- Organizimin dhe kryerjen, në bashkëpunim me QNOD, Mbrojtjen Civile dhe ministrinë përgjegjëse për mjedisin (ARM) operacionet e pastrimit të bregdetit

Autoritetet Lokale (operatorët dhe menaxherët dhe/ose qiramarrësit të porteve, kantierëve, pontileve të naftës, platformave detare, tubacioneve dhe anijeve që mund të shkaktojnë një derdhje të naftës apo të substancave të rrezikshme dhe helmuese.

- Përgatitjen e Planeve për reagimin në Shkallën 1 të ndotjes detare;
- Mirëmbajtjen e kapaciteteve reaguese për reagimin fillestar ndaj incidenteve me ndotje në facilitetin e tyre;
- Përcaktimin e Kontrolluesit të Incidentit;
- Organizimin e trajnimeve dhe ushtrimeve në nivel lokal;
- Lajmërimin e QNOD për çdo derdhje të konstatuar në det;
- Reagimin ndaj incidenteve të Shkallës 1 në përputhje me Planet përkatëse;
- Pjesëmarrjen në operacionet e reagimit të Shkallës 2 apo 3 Planet përkatëse.

#### Bashkitë dhe Komunitat

- Organizimin dhe kryerjen, në bashkëpunim me QNOD, mbrojtjen Civile dhe Ministrinë përgjegjëse për mjedisin operacionet e pastrimit të bregdetit.

#### Ministria përgjegjëse për çështjet detare (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit)

- Bashkëpunimin me QNOD për çdo çështje lidhur me përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve që shkaktojnë apo mund të shkaktojnë ndotje detare;
- Parashikimin dhe mbështetjen e të gjitha aktiviteteve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare në lidhje me përgatitjen dhe reagimin ndaj një ndotje detare;
- Koordinimin me QNOD dhe Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe marrjen e vendimit për pjesëmarrje në trajnime dhe ushtrime në nivel ndërkombëtar;
- Në përputhje me kërkesat e FUND 1992, sigurimin që importuesit e naftës të paguajnë kontributin e tyre vjetor.

#### Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD)

- Bashkëpunimin me QNOD për çdo çështje lidhur me përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve që shkaktojnë apo mund të shkaktojnë ndotje detare;
- Raportimin në Organizatën Ndërkombëtare të Detarisë dhe ndonjë organizatë ndërkombëtare tjetër sipas rastit;





## ANEKSI 5.

### LISTA E KONTAKTEVE

#### TE ADMINISTRATAVE, ORGANIZATAVE, SHERBIMEVE DHE INSTITUCIONEVE KOMBETARE, PARASHIKUAR PER TE MARRE PJESE NE ZBATIMIN E PLANIT KOMBETAR TE EMERGJENCES, DUKE PERFSHIRE DHE TE DHENAT PER KONTAKTIN E PERSONAVE PERGJEGJES

(Për tu kompletuar jo me vonë se 6(gjashtë) muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Vendimit të Këshillit të Ministrave mbi miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave)

## ANEKSI 6.

### LISTA E PAJISJEVE NË BREG DHE INSTALIMEVE NË DET QE U NEVOJITET TË KENË NJË PLAN TË SHKALLES 1

Për tu kompletuar sipas nevojës me emrat dhe vendndodhjen e saktë të pajisjeve në breg dhe instalimeve detare menjëherë dhe jo më vonë se 6(gjashtë) muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me miratimin e Planit)

#### Portet shtetërore:

Porti i Durrësit / Autoriteti Portual Detar  
Porti i Sarandës  
Porti i Shëngjinit  
Porti i Vlorës

#### Porte/terminale private:

- Porti "Vlora -1", Terminali i Naftës i administruar nga shoqëria "La Petrolifera Italo Albanese" sh.a. (Gjiri i Vlorës)
- Porti "Porto Romano" i administruar nga shoqëria "Romano Port" sh.a., (Porto Romano, Durrës)
- Pontili i Naftës i "ARMO" sh.a., Nartë, (Gjiri i Vlorës)

#### Porte të tjera:

"Treport" port peshkimi (afër Vlorës)

#### Njësitë detare:

Dy unaza karburanti që operojnë në Gjirin e Vlorës

#### Pajisje në breg:

Termocentrali i Vlorës (KESH sh.a.)

Aneksi 7  
**PRIORITETET PER ZBATIMIN E  
PLANIT KOMBETAR TE KONTIGJENCES**

Duhet të kompletohet me vendndodhjet e sakta të lagunave bregdetare si dhe zona të tjera të ndjeshme mjedisore, rezervatet e peshkut etj menjëherë dhe jo me vonë se 12(dymbëdhjetë) muaj pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me miratimin e Planit)

Lagunat bregdetare:

Laguna e Karavastasë (Perëndim të Lushnjës, në pjesën qendrore të bregut, deklaruar si Park Kombëtar)  
Laguna e Nartës (VP të Vlorës, në pjesën qendrore të bregut)  
Laguna e Butrintit (J të Sarandës në pjesën Jugore të bregut)  
(çdo lagune tjetër bregdetare që mund të preket nga ndotja e detit nga karburanti apo LRH)

Rezervatet e peshkut dhe të midhjeve:

Tre (3) rezervate peshku brenda Gjirit të Vlorës  
Rezervate të ndryshme peshku dhe midhjesh në zonën e Sarandës  
(çdo rezervat tjetër peshku apo midhjesh)

Zonat e shtimit të peshqve:

Vende që nuk dihen nga konsultuesi

Zona arkeologjike nënujore:

Vende që nuk dihen nga konsultuesi


Pajisje në breg:

Termocentrali i Vlorës (KESH sh.a.)



### ANEKSI 8.

### GRAFIKU I QARKULLIMIT TE INFORMACIONIT NE NDOTJET DETARE



## ANEKSI 9.

### POLREP SISTEMI I RAPORTIMIT TË NDOTJES

1. Sistemi i Raportimit të ndotjes POLREP rekomandohet të përdoret midis Shteteve Anëtarë të Protokollit për Parandalimin dhe Emergjencat të Konventës së Barcelonës dhe midis Palëve Kontraktuese dhe Qendrës Rajonale, për shkëmbimin e informacionit kur ndodh një ndotje e detit në rajonin Mesdhetar ose kur është prezent një kërcënim i tille.
2. POLREP i ndare në tre pjesë:
 

1 Pjesa I ose POLWARN (shifrat 1 – 5)	<b>POLLution WARNing</b>	jep informacionin fillestar ose paralajmërimin e ndotjes apo kërcënimit
2 Pjesa II ose POLINF (shifrat 40 – 60)	<b>POLLution INFormation</b>	jep raportin plotësues të detajuar gjithashtu edhe raportimet e situatës
3 Pjesa III ose POLFAC (shifrat 80 – 99)	<b>POLLution FACilities</b>	Përdoret për të kërkuar asistencë nga një Palë Kontraktuese tjetër dhe për të përcaktuar çështjet operative në lidhje me asistencën
3. Ndarja në tre pjesë bëhet vetëm për qëllim identifikimi. Për këtë arsye nuk janë përdorur figura të njëpasnjëshme. Kjo i mundëson marrësit të dallojë thjesht duke parë shifrat nëse ai ka të bëjë me pjesën I (1-5), pjesën II (40-60) apo pjesën III (80-99). Kjo metodë e ndarjes nuk duhet të përjashtojë përdorimin e të gjitha shifrave në një raport të plotë ose përdorimin e ndare të shifrave të veçanta prej çdo pjesë ose përdorimin e shifrave të veçanta nga pjesë të ndryshme të përziera në një raport.
4. Pjesa I përdoret si një paralajmërim midis Palëve Kontraktuese të Protokollit të Parandalimit dhe Emergjencës në Konventën e Barcelonës. Është i mundshëm dhe përdorimi i prioritetit të trafikut URGENT.
5. Pjesa II është pasojë logjike e pjesës I. Pas transmetimit të pjesës I, Pala Kontraktuese mund të informojë Palën tjetër Kontraktuese për vlerësimin e saj të natyrës dhe shtrirjes së incidentit duke përdorur shifrat përkatëse nga pjesa II.
6. Pjesa III është ekskluzivisht për të kërkuar asistencë dhe çështje që lidhen me të.
7. Përshkrimi i detajuar i shifrave të ndryshme në pjesët I, II dhe III të POLREP janë dhënë në **Tabelën 1**.
8. Një listë e përmblodhur POLREP është dhënë në faqen pasardhëse.
9. Një shembull i mesazhit POLREP duke përfshirë pjesët I, II dhe III është e dhënë në fund.



## Liste e përmbledhur e një POLREP

	Adresa	nga: ...	ne drejtim te: ...
	Data	Koha	Grupi
	Identifikimi		
	Numri serisë		
<b>Pjesa I (POLWARN)</b>	1	Data dhe koha	
	2	Pozicioni	
	3	Incidenti	
	4	Derdhja	
	5	Pranimi	
<b>Pjesa II (POLINF)</b>	40	Data dhe koha	
	41	Pozicioni	
	42	Karakteristikat e ndotjes	
	43	Burimi dhe shkak i ndotjes	
	44	Drejtimi dhe shpejtësia e erës	
	45	Rryma apo batica	
	46	Gjendja e detit dhe shikueshmëria	
	47	Përhapja e ndotjes	
	48	Parashikimi	
	49	Identifikimi i vëzhguesit dhe anijeve ne vendngjarje	
	50	Veprimet e marra	
	51	Fotografitë ose mostrat	
	52	Emrat e Shteteve te tjera te informuara	
	53 – 59	Tepricat	
60	Pranimi		
<b>Part III (POLFAC)</b>	80	Data dhe koha	
	81	Kërkesa për asistencë	
	82	Kostoja	
	83	Marrëveshjet paraprake për dorëzimin	
	84	Asistenca për ku dhe si	
	85	Shtetet e tjera qe u kërkohet	
	86	Ndryshimi i komandimit	
	87	Shkëmbimi i informacionit	
	88 – 98	Tepricat	
	99	Pranimi	

**Table 1**

PERMBATJA	VEREJTJE
ADRESA	<p>Çdo raport duhet të fillojë me një të dhënë të shtetit në adresë të cilit autoriteti kombëtar kompetent po e dërgon atë p.sh.</p> <p>NGA: ALB (tregon shtetin i cili dërgon raportin)            PER: ITA (tregon shtetin të cilit i dërgohet) ose            REMPEC (tregon që mesazhi është dërguar Qendrës Rajonale).</p>
D.O.G (Data Ora Grupi)	<p>Ditën e muajit e ndjekur nga koha (ora dhe minutat) për hartimin e mesazhit. Gjithmonë një grup i 6-shifror i cili mund të pasohet nga treguesi mujor. Koha duhet të tregohet edhe si GMT, p.sh. 092015Z qershor (d.m.th. 9 të muajit përkatës, në 20,15 GMT) apo si kohë lokale p.sh. 092115LT Qershor.</p> <p>DTG mund të përdoret si një referencë.</p>
